


Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

BIBLIOTEKA

854
K 14



Ismail
Kadare

83 (04x)
91.983 [fuzeni]
33.09



ISMAIL KADARE



8
K 14

ISMAIL KADARE

Belira.

ARDHJA E MIGJENIT
NË LETËRSINË SHQIPE



SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»
TIRANË 1991

Redaktor: ARSHIN XHEZO

**Recensues: NASI LERA
PIRRO MISHA**

**Piktör: ARDIAN KARAKASHI
Redaktor teknik: PIRRO PANDELI
Korrektore letrare: NINI IHSANI**

1

Kur Millosh Gjergj Nikolla, me pseudonimin Migjeni, djalosh i ri nga Shkodra, i brishtë, elegant dhe serioz (pamje tipike e një pjese të rinisë intelektuale të viteve 30, që pasi kalonin nga libraria e qytetit, uleshin në kafene për të diskutuar për problemet ose më saktë mërzinë e kohës), kur Migjeni, pra, nisi të magjepsej nga arti i të shkruarit, letërsia shqipe kishte katërqind vjet që ekzistonte.

Një grumbull i madh shkrimtarësh, poetësh e njerëz të letrave, të mëdhenj e të vegjël, me fat e pa fat, të thjeshtë e të ndërlidhur, kishin lëvruar arën e saj të vështirë e të sertë si vetë trualli i vendit.

Ishte vështirë që në një hapësirë tjetër kaq të ngushtë, të gjeje një larmi kaq të madhe tipash e fytyra letrarësh si në Shqipëri. Murgjër të thjeshtë, që në vetminë e famullive sajonin vjer-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

shat apo sonetet e para, dendi të mësuar nëpër saj lone evropiane, klerikë savantë, që kishin letërkëmbim me papën, patriotë martirë të rrëzuar nga thika ose helmi, guximtarë të çmendur, që s'e kishin për gjë të gërs hetonin artin e të shkruarit me karrierën, të ishin shkrimtarë e njëkohësisht ambasadorë e ministra, poetë lirkë në vendin e tyre e guvernatorë tiranë në tjetër vend, kampionë të lirisë këtu e cenzorë perandorakë atje, përmbyssës sundimtarësh e të përbysur pastaj edhe vetë brutalisht etj., etj.. popullonin këtë galeri të pazakontë.

Këta shkrimtarë me portrete, veshje e fate të çuditshnre, kishin ngritur gur pas guri e mur pas muri ngrehinën e letërsisë, atë ngrehinë që në vendë të tjera do të mund të quhej tempull, por që në Shqipëri vështirë se mund t'i shkonte ky emër. Më tepër se e tillë, ngrehina e letërsisë shqipe ishte gjysmë tempull, gjysmë kështjeilë, gjysmë kullë, gjysmë manastir, e ashpër e spartane, si rrallëkund.

Treqind vjetët e parë të saj (shekujt XVI-XVIII), ajo që mund të quhej «koha e bronzit» përbëhej nga një numër veprash në prozë e në poezi të krijuara kryesisht prej shkrimtarësh klerikë katolikë në shqip e në latinisht. Këta ishin shkrimtarë me kulturë të madhe, që kishin mbaruar fakultetet teologjike në universitetet më të dëgjuara të Evropës dhe që nuk e kishin për gjë që veprat e tyre. me atë lehtësi që i botonin në Shqipëri t'i botonin në Romë, në Paris ose në Madrid.

Për të kuptuar se ç'përfaqësonin këto vepra, mjafton të përmendim njëren prej tyre, «Rrethimi i Shkodrës», të shkruar nga Marin Barleti, prift ushtarak në trupat shqiptare që mbrohin Shkodrën prej turqve në shekullin XV. Kjo kronikë e tmerrshme, ku nuk është harruar asgjë, që nga sasia e gjyleve, që binin cdo ditë mbi kështjellë, te kafshët e sëmura që hidheshin me katapultë pér të shkaktuar epidemi, gjer te halucinacionet e mbrojtësve e britmat e sulmuesve, njëra prej të cilave, «Roma! Roma!», tregonte se pas Shkodrës i vinte radha Romës e pastaj gjithë Evropës, ndonëse e botuar më 1504, lexohet me një frymë ende edhe sot. E shkruar në latinisht, pér t'i dëshmuar botës mbarë aktin e fundit të tragjedisë së shqiptarëve, ajo është jo vetëm kënga e tyre funebre, por si rrallë vepra të tjera të letërsisë evropiane të kohës, jep tërë ankthin e qytetërimit të krishterë përparrë sulmit islamik. Nuk është e rastit që vepra, pas botimit të parë në Venedik, u përkthyte u bota në Bazel të Zvicrës më 1566, në Frankfurt më 1578, e më pas në Paris, në Brest-Litovsk e me radhë në shumë vende të kontinentit.

Midis shkrimitarëve që u shquan në këtë periudhë ishin Pjetër Budi (1566-1622), Frang Barthi (1606-1643) dhe Pjetër Bogdani (1625-1689), të tre personalitete të mëdha të kulturës shqiptare e të asaj evropiane njëkohësisht. Që ishin të tillë, vërtetohet prej faktit që vepra e tyre ka tjerhequr e vazhdon të férheqë ende sot vëmendjen e studiuesve të Evropës.

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

Në veprën e tyre të gjerë, përveç motiveve fetare, filozofike e kozmogonike, ka pjesë të freskëta e të fuqishme në formë kronikash e dëshmish për ngjarjet e kohës, letra e relacione dramatike, vjersha e poëma nga më të ndryshmet. Midis këtyre të fundit, si perla të hedhura pa kujdes, shkëlqejnë aty-këtu strofa e vargje të një bukurie të rrallë, që ngjajnë edhe më befasuese në atë muzg mesjetar.

Rëndësia e kësaj periudhe të parë e tepër të gjatë të letërsisë shqipe është e jashtëzakonshme. Së pari, ajo përpunoj gjuhën letrare të shqiptarëve, këtë makinë të ndërlikuar që duhej të gati-tej pér të përballuar mendimin e paqetë, plot fantazma e imazhe tronditëse të një prej popujve më të moçmë të kontinentit, fqinjitet më të afërt të grekëve të vjetër, e që pér më tepër ndodhej në zi, kohë kur fjala kërkon masë e peshë të veçantë. Së dyti, ajo u siguroi letrave shqipe vazhdimësinë e lidhjes, pra, kordonin ombilikal me kontinentin mëmë: Evropën. Nuk ishte e paktë që treqind e ca vjet pas pushtimit osman, në kohën kur Shqipëria dukej se pér jetë të jetëve i kishte kaluar kontinentit aziatik, letërsia e saj vazhdonte të mbetej tërësisht evropiane.

Ndonëse kishte kohë që një pjesë e zotërve shqiptarë, duke u konvertuar në fenë islamike nga kontë e baronë, ishin kthyer në pashallarë, bibliotekat e kështjellave të tyre ishin plot me libra shqip e latinisht. Në to, përveç murgjve e shqiptarëve të krishterë, vinin shpesh shqiptarë

të konvertuar, të cilët apo hynin në atë univers të mbuluar nga tisi i harresës, rigjenin heronjtë e largët antikë, sibilat, Krishtin, luftërat iliriko-romake, arkivat shqiptaro-venedikase, regjistra e kronika manastiresh, muret e të cilave nxinin tani nga braktisja. I gjenin, pra, të gjitha këto dhe atëherë e ndienin se emrat e tyre të rinj myslimanë, Ibrahim e Abdulla, s'ishin veç një lëvozhangë e hollë, që do të thyhej nga tronditja më e parë.

Në kohët e mëvonshme, e sidomos në vitet e Rilindjes Kombëtare, që u ndikua aq shumë prej Revolucionit Francez, konvertimi i një pjese të shqiptarëve në fenë islamike do të shërbente për të ushqyer tezën se shqiptarët prej natyre ishin afetarë, ngaqë e merrnin fenë jo fort seriozisht, tezë e cila do të shfrytëzohej po aq nga armiqtë më të egër të kombit shqiptar, për të vërtetuar se shqiptarët ishin të paqytetëruar, sa edhe nga studiues mendjelehtë të mëvonshëm, për arsyen konformizmi politik.

Në të vërtetë, brigjet shqiptare ishin vendi ku krishtërimi nisi të përhapej qysh në shekullin I, fill pas Romës. Më pas, Shqipëria e hershme mesjetare ishte një nga zonat më të evropianizuara të kontinentit dhe mjafton të hetohen afresket e kohës, altarët dhe ikonat e mrekullueshme të piktorëve të tillë të mëdhenj, si Onufri e Shpataraku, për të ndier së si ngjyrat, motivet e simbolet e krishtërimit, u dendësuan e u përndritën këtu tragjikisht e me një bukuri fatale, pikërisht në prag të duhmës islamike, që po afrohej kob-

shëm, me shenjat e veta, që për të krishterët shqiptarë s'ishin veçse shenjat e satanait. Mjafton të përmendim, gjithashtu, se kryesori ndër dy-tre emrat që diskutohen ende sot për autorësinë e himnit më të famshëm të liturgjisë së krishtere të mbarë botës «Te Deum» (Te Deum laudamos), krijuar në shekullin IV, është peshkopi shqiptar Niketë Dardani.

Nga kjo pikëpamje, shqiptarët nuk ishin as më pak e as më shumë fetarë se sa italianët, që i kishin përballë, se francezët e jugut, se dalmatët në veri, apo grekët në jug të tyre. Veç këtu duhet thënë se trojet shqiptare ishin pikërisht ato ku përplasja e feve, në fillim katolicizmi me ortodoksizmin e pastaj të dyja bashkë me islamizmin, u krye në mënyrën më dramatike. Konvertimi ishte një nga pasojat e kësaj traume.

Si një lëkundje sizmike e vazhdueshme, ai shkaktonte çarje jo vetëm midis qyteteve e kattundeve, por shpeshherë edhe brenda një vatre familjare, ku njëri vëlla mbetej i krishterë e tjetri, ai që do të nisej për të bërë karrierë në kryeqytetin e perandorisë, qe i detyruar të konvertohet. Kishte madje të tjerë, «criptokatolikët», që duke qenë të konvertuar e ruanin fshehtazi fenë e vjetër, madje e quanin të zakonshme të mbanin dy emra dhe të kishin dy tempuj, çka shkaktonte nervozizëm në Vatikan. Duhet shtuar, ndërkaq, se në zonat ku shqiptarët fqinjëronin me sllavët, konvertimi u krye, vec të tjerash, si një ledh mbrojtës kundër dyndjes sllave e rrezikut të përzierjes

me ta. Fakti që u konvertuan kryesisht ortodok-sët, pra ata që kishin të njëjtën fe me sllavët e jo katolikët, e vërteton këtë.

Kjo ndrydhje dramatike, ky krishtërim i fshehur brenda vetes, duhej të ndihej, megjithatë, aq qartë nën tisin e praruar festiv islamik, saqë një raportues i kohës e niste kështu kumtësën e vet: «Shqipëria, krahinë e vërtetë heroike e Ilirisë, e cila me titull të merituar mund të quhet Irlandë e Evropës Lindore» etj., etj.

Dëshmi e këtij krishtërimi të ndryrë ishte (për të përmendur një fakt nga koha jonë) ndezja e papritur e dhjetëra mijëra qirinjve prej shqiptarëve, në shenjë nderimi për viktimat që shkaktoi policia serbe në fillim të vitit 1990. Kjo përndritje e krishterë e Kosovës i nervozoi veçanërisht shovinistët serbë, të cilët duke e ditur përcëmimin e evropianëve ndaj fundamentalizmit islamik, që në përpjekur vite me radhë t'i paraqitnin shqiptarët e Kosovës si gjoja myslimanë të prapambe-tur, që luftonin kundër krishtërimit serb!

Që shqiptarët s'ishin kurrfarë myslimanësh të bindur e kishte vërtetuar viti 1924, kur ata zgjodhën njëzëri si kryetar të shtetit një prift, Fan Nolin. Qenë serbët, përkundrazi, që kundër këtij kryeministri të ndritur, ndihmuani mbretin mysliman Ahmet Zogun të merrte pushtetin. Duke qenë se si të gjithë ata që vuajnë nga komplekset, më shumë se çdo gjë i mërzit kultura e tjetrit, shovinistët serbë i nervozonte qytetërimi i shqiptarëve dhe bënин çmos (çka vazhdojnë ta

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

bëjnë edhe sot), të prisnin fillin ombilikal që e lidhte këtë qytetërim me Evropën.

Kështu, pra, për më shumë se treqind vjet, pavarësish ç'ndodhët në këtë vend ku minaret shtoheshin si kërpudhat dhe daullja e Orientit të shurdhonte, letërsia shqipe mbeti, megjithatë, evropiane dhe homogjene. Kjo ishte vendimtare për fatin e saj. Nga ana tjeter, kjo dëshmonte se pavarësish nga furtunat lart, në sipërfaqe, poshtë në zgafellat e kombit, atje ku administratat dhe propaganda nuk zbrisnin dot, kishte diçka që s'ndryshonte kurrë. Të ndërhyje në të ishte po aq e pamundur si të ndërhyrje në kodin gjenetik të racës.

Kjo letërsi kokëfortë, pra, punonte ditë e natë, qiri i zbehtë, por i pashueshëm nga furtunat e kohës.

Rrezikun e këtij statusi të çuditshëm osmanët e kuptuan tepër vonë. Ata u përpoqën në shekullin XVIII, me anën e nxitjes së rrymës letrare të bejtexhinjve, të krijonin një diversion në letërsinë shqipe, por tashmë ishte vonë për këtë. Kjo rrymë proorientale dhe në kundërshtim me kahjen e historisë, s'e kishte as peshën e as seriozitetin për t'i qëndruar përballë letërsisë shqipe, ndaj ajo u fshi prej saj si një kujtim grotesk.

¶ Një veçanti origjinale e zhvillimit të letrave shqipe, vecanti kjo e përbashkët e disa vendeve të Ballkanit, ishte vendi që zinte në to poezia orale. Si një korpus vullnetarësh që shoqëron ushtrinë e rregullt, ashtu edhe korpusi i rapsodëve

e poetëve anonimë popullorë shoqëronte në avenirë e tyre të madhe letërsitë ballkanike. Por këtu duhet thënë se, si çdo korpus vullnetarësh, ai ishte herë-herë më i furishëm, më i lirë e shkumëzues në aksionin e tij. Shpërthim i pakontrollueshëm, ai popullonte me fantazma tronditëse hapësirën paksë të ftohtë akademike e tepër elitiste të letërsisë së vjetër shqipe, ia ngrakte venat e ngrira, çelte zymltinë manastirore të saj. Poezia orale, vazhdim i venës së dikurshme antike, sillte në letërsinë shqipe motive të ndaluara, jashtë paragjykimeve e dogmave të kohës, madje disa herë të tilla saqë të ngriheshin leshrat e kokës përpjete.

Për një kohë të gjatë këto dy letërsi, e kultivuara dhe oralja, qëndruan të ndara si dy botë të padukshme, që e kanë të pamundur të hyjnë në lidhje me njëra-tjetrën. Ato u zhvilluan kështu veç e vec, secila sipas ligjeve të saj, në një mos-përfillje të plotë për njëra-tjetrën. Më vonë, sidomos me mbarimin e kohës së bronzit dhe me afrimin e shekullit të madh për letërsinë shqipe, shekullit XIX, që mund ta quajmë edhe «shekulli i argjendtë», këto dy universe nisën të afrohen, dhe kështu, herë duke u ndikuar nga njëri-tjetri. herë duke u marrë vesh e herë duke u kundërshtuar, bashkëjetuan për një kohë të gjatë.

Shekulli XIX ishte me të vërtetë i veçantë në letërsinë shqipe. Ai ishte shekulli i Rilindjes Kombëtare, koha magjepsëse kur pas një nate roberie katërqindjeçare ndihej që mëngjesi nuk

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

ishte larg. Mendjet e të gjithëve ishin kthyer drejt tij. Të poetëve e të shkrimtarëve në radhë të parë. Ata ishin me dhjetëra për të mos thënë me qindra, që morën penën pér të shtuar një vepër, një poemë, një faqe ose një strofë në letërsinë shqipe. Në krye të kësaj armate të pafundme ishin poetët e mëdhenj Naim Frashëri e Jeronim de Rada. Fill pas tyre vinin poetët e tjerë të shquar Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda e Zef Serembe. Dhe pas tyre një aradhë e tërë shkrimtarësh, poetësh, eseistësh, filozofësh, publicistësh, oratorësh, polemistësh etj.; etj., që vit pas viti, stinë pas stine e ditë pas dite plotësuan kronikën e asaj kohe të paharruar.

Rilindasit, të mëdhenj e të vegjël, u përpinqën të krijonin ëndrrën pér Shqipérinë e pér shqiptarët. Ata e ndien se pa këtë ëndërr, pa këtë aspiratë, ishte vështirë të zgjohej e të vihej në lëvizje një popull, breza të tërë të të cilit kishin lindur e kishin vdekur në robëri. Ata u vunë të vërtettonin se Shqipëria ishte një nga vendet më të veçanta në botë e se shqiptarët ishin një nga popujt më të vjetër, më fisnikë e më të aftë midis popujve evropianë. Pér të dëshmuar këtë, ata, jo vetëm shkruan himne e poema, por mblozhën fakte, hartuan studime, qëmtuan emra e ngjarje. Të pajisur me kulturë të jashtëzakonshme, nuk e patën vështirë të zbulonin motive të përbashkëta mitologjike midis botës shqiptare e asaj greke të lashtë, të gjenin në Shqipëri mbeturina tempujsh e teatrosht ku qenë luajtur drama antike,

vende ku qenë endur heronjtë e Homerit, fjalë e emra hyjnish grekë që shpjegoheshin pas gjuhës shqipe, madje shpella e lumenj nëpërmjet të cilëve hyhej në ferrin e të vjetërve. Pasi i siguruan kulturës së popullit të tyre rrënje të tilla, u rrekën të ringjallnin Shqipërinë paraturke, vendin e zhvilluar plot me kontë e baronë, me kështjella, katedrale, me kanceleri, krushqi e skandale, si çdo vend tjetër i krishterë evropian. Me këtë pikturë, që ndonëse në penat e tyre idealizohej, ishte në thelb e vërtetë, ata donin ta bënин njeriun shqiptar të ndërgjegjshëm për atë që kishte humbur dhe, duke ia shtuar kësisoj brengën, t'i shtuin rrjedhimisht padurimin për ta kthyer atë realitet, që në veprat e tyre të kujtonte, as më shumë e as më pak, një parajsë të humbur.

Të pakënaqur gjer në fund me ringjalljen e kësaj tabloje, rilindasit zbritën edhe më thellë në histori. Ata hulumtuan me kujdes gjithçka që kishin thënë shkencëtarët e huaj e sidomos ata gjermanë për prejardhjen e shqiptarëve prej ilirëve. Mirëpo në gadishullin ku prejardhja e fisime çmohej më shumë se gjithçka dhe ku zotëronte bindja se ajo do të luante rolin themeloi në statusin e ardhshëm të kombeve (çka dhe ndodhi në njëfarë mënyre më pas), kjo tezë do të zgjonte xhelozinë e fqinjëve sllavë, për të cilët ishte e padurueshme ideja që shqiptarët të quhen pas ardhësit e vetëm të ilirëve, rrjedhimisht të ishin autoktonë në gadishullin ku sllavët ishin të ardhur. Për këtë arsy, fqinjët sllavë, e veçanërisht

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

serbët, i vunë detyrë vetes t'u gjenin një prejardhje, ose më saktë, një ardhje shqiptarëve, por që ajo të ishte detyrimisht më e vonë se data e mbërritjes së sllavëve në Ballkan d.m.th. shekulli VII. Kështu ata do të rrekeshin për shumë kohë që të gjenin itinerarin enigmatik të shqiptarëve, disa duke hamendësuar zbritjen e tyre nga Skocia, e të tjerë nga zonat baltike, nga veriu i ftohtë apo Kaukazi me borë. Nuk mbetën pa u përzier në këto pandehma emra popujsh të tillë të largët si keltët dhe baskët, në gjuhët e të cilëve u besua se mund të gjendeshin afri me shqipen.

Rilindasit, ndonëse ishin tepër përbuzës ndaj fqinjëve shovenë, sikur ta parandienin megjithatë këtë kacafytje të ardhshme, u treguan të kujdesshëm që në veprat e tyre të shkruanin hollësisht për shtetet dhe mbretëritë ilirike, luftërat me Romën e pathyeshme, perandorët e papët me origjinë ilire. Të njëjtën gjë ata bënë për gjuhën shqipe, të cilën, të ekzaltuar nga interesimi që ajo kishte zgjuar te gjuhëtarë të mëdhenj, si Gottfried Leibniz, Franc Bopp e të tjerë, ishin gati ta shpallnin gjuhë hyjnore. Kështu, vite me radhë, rilindasit u rikujuan shqiptarëve se ata ishin, ashtu si grekët e vjetër e romakët, një popull i zgjedhur e me predestinacion të veçantë, por që fati nuk u kishte ecur. Shembujt e freskët që jepte koha, postet e larta që shqiptarët kishin fituar në Perandorinë Osmane, njëlloj si dikur ilirët në atë romake (ndonëse pakëz të hidhur e jo fort të

volitshëm politikisht), shfrytëzoheshin në shërbim të idesë së elitizmit.

Duhet thënë se kjo ide nuk do të kishte kurrfarë përhapje, në qoftë se nuk do të gjendej qysh më parë, ndonëse e dremitur, te shqiptarët. Në psikikën e tyre, e sidomos të asaj pjese që jetonte në male, bota shqiptare, e rregulluar sipas kodit zakonor, ishte më e mira ndër të mundshmet. Të térhequr në vetminë e maleve, ata ndiqnin me mospërfillje atë çka ndoshta *atje poshtë*, dhe ash tu si për grekët, popujt e tjerë, që nuk flisnin gjuhën e tyre ishin *barbarë*, për shqiptarët, të tjerët, d.m.th popujt pa kod, ishin *amoralë*.

Pra, rilindasit, duke mos qenë shpikësit e krenarisë së shqiptarëve, ishin megjithatë ata që e zgjuan nga gjumi dhe, c'është kryesorja, ata që e mbështetën atë me një doktrinë.

Gjithmonë si një rikumbim i idesë së mundësive të pakufishme të njeriut shqiptar, u përpunuua edhe një konceptim i veçantë, i ri për atë kohë, i hapësirës dhe i kohës në poezinë shqipe, çka i dha asaj një tingëllim universal. U shquan veçanërisht për këtë dy liderët e saj, De Rada e Naim Frashëri. I pari krijoi në krejt veprën e tij poetike një përmasë kohore mitike, që shtrihej e rrrokullisej zëpër shekuj lehtësish e pa kurrfarë kufijsh. Në poemat e tij plot me ditare prin ceshash shqiptare, që martoheshin larg, me zjarre pashkësh e tinguj kambanash, që aq rrallë dëgjo heshin tanë në Shqipërinë gjysmë të islamizuar, realiteti dhe ëndrra gërshtetoheshin natyrshëm,

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

saqë mund të thoshe se Shqipëria, që ai përpinqej ta ngjallte së vdekurish, ishte më e pranishme në këto poema se Shqipëria reale, që ngjante si e rënë në komë.

I dyti, Naim Frashëri, si për të kundërpe-shuar ngushtësinë e vendit të vet, krijoj në poezi një hapësirë pothuajse perandoreske, nëpër të cilën vërtiteshin personazhet e disa herë fantazmat e tij, siç qe, p.sh., fati i përfytyruar i vendit: (U ngrit fati i Shqipërisë, si i vdekuri nga varri, mori udhën e Azisë, duke rendur si i marri) etj., etj. Ai shkroi për ndeshjet e mëdha jo vetëm midis shqiptarëve e turqve, por për luftëra të tjera, më të gjera e të përgjithshme, të nxitura nga shkaqe të errëta fetare, si ajo që përshkruhet në poemën e tij të gjatë të tipit homerik «Qorrbelaja», ku si në një sherr të verbër, siç e thotë edhe titulli i poemës, (në qoftë se do të pranojmë titullin «Qorrbelaja» e jo «Qerbelaja»), përfyten në shkretëtirën arabike sekte e popuj myslimanë, në një ndeshje, që po aq verbërisht, vazhdon edhe sot në ditët tona.

Duhet thënë se në evokimin e karrierës së shqiptarëve, rilindasit patën qëndrime të ndryshme ku mund të gjeje ekzaltime, po aq sa edhe qortimin, siç ndodhë te thirrja e njohur e Çajupit: (Mjaft punove për të tjerë, o fatkeq!).

Por, kur ishte fjala për vlerat e brendshme të bashkatdhatarëve të tyre rilindasit u treguan unanimë. Ata krijuan mitin e njeriut të veçantë shqiptar, me cilësi e virtute të jashtëzakonshme:

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

besën, burrerinë, nderin, mikpritjen, zakonet etj. Në të gjitha këto, ata i ndriçonin vetëm njérën anë, atë që u interesonte, duke lënë mënjanë ngjyrimin tragjik që shoqëronte shpesh këtë traditë. Ata e dinin fort mirë se njeriu shqiptar, ashtu si njerëzit e krejt gadishullit ose kontinentit, krahas vityteve kishte edhe vese e mungesa të mëdha, mirëpo këto nuk duheshin thënë, për hir të ëndrrës. Ishte logjika e së nesërmes, e mëngjesit që po afronte, ishte drita, dehja, optimizmi i tij që kushtëzonë gjithçka.

Rilindasit krijuan kështu mitin e Shqipërisë «zonjë të rëndë», të fyer, e të shqiptarëve komb i zgjedhur por që në jetën e të cilëvë kishte ndodhur një katastrofë: pushtimi osman. Kjo katastrofë duhej ndrequar me çdo kusht. Gjithë aksioni i rilindasve mund të përmblidhej kështu me dy fjalë: riparimi i një katastrofe.

Ai riparim do të bëhej në shekullin XX, por siç ndodh gjithmonë me ëndrrat e ëndërruara tepër gjatë, duke qenë vërtet shekulli i pavarësisë, ai do të ishte njëkohësisht shekulli i zhgënjimit të madh.

Në historinë mijëvjeçare të shqiptarëve ai është shekulli më i pasur në ngjarje, më i ndërlikuari e më dramatiku. Për letërsinë shqipe, ai është «shekulli i artë».

Migjeni erdhi në letërsi pikërisht në këtë shekull...

— 17 —



Në rininë e tij të parë Migjeni duhej të kishte pasur një njojje disi të mjegullt të të gjithë kësaj. Në qytetin e tij të lindjes, në Shkodër, ai kreu vetëm shkollën fillore, për tu larguar në moshën dymbëdhjetëvjeçare jashtë shtetit, në Jugosllavi, ku do të kryente, në fillim në Tivar e pastaj në Manastir, shkollën e mesme e seminarin fetar ortodoks.

Në shkollë të huaj, ku nuk dëgjohej gjuha shqipe e nuk përmendej as Shqipëria e as shqiptarët, Milloshit të vogël i duhej t'i vinin si përmes një tymtaje ato që kishte mësuar në fëmini përvendin e tij; portretet hijerëndë të princëve mesjetarë, poetët e mëdhenj, rrëfimet, ritet.

Edhe në Shkodër Milloshi kishte qenë një fëmijë jo fort i shoqërueshëm. Më tepër se prej karakterit të tij kjo që shkaktuar prej një rrethane të veçantë: prej fesë së familjes së tij. Shko-

~~dra ishte qyteti më i përçarë shqiptar në punë feje. I ndarë si me thikë midis katolikëve dhe myslimanëve, ai shkumëzonte nga pasionet e të dyja palëve kundër njëri-tjetrit. Tingujt e kam-banave acaronin gjithë ditën veshët e myslimanë-ve, ashtu si zërat e hoxhallarëve ato të katolikë-ve. Një traditë e tërë urrejtjeje, e mjaftueshme të ushqente breza të tërë njerëzorë, mbahej gja-llë me të gjitha mjetet: libra, revista, shoqata, pro-cesione, thashetheme, përdhosje vendesh të she-njta, grindje, vrasje e gjer te masakra që shman-geshin me vështirësi.~~

Midis këtyre dy deteve armiqësore, në qytet jetonte një minoritet i paktë (jo më shumë se një-qind familje), të një feje të tretë: ortodokse. Fa-milja e Migjenit, ndonëse jetonte në pjesën kato-like të Shkodrës, i përkiste këtij ishulli.

Kuptohej që Milloshi i vogël, tek i cili nuk ngjiste dot urrejtja e asnjë pale kundër palës tje-tër, i paftë për të ulëritur në njërin klan kundër tjetrit, kishte mbetur më shumë i vetmuar se me shokë.

Kjo ndjesi vetmie do t'i shtohej më tepër në Jugosllavi për arsyen tashmë të thjeshtë se ai mbante brenda tij një botë krejtësisht të huaj e të panjohur për të mos thënë të padashur për nxënësit sllavë: botën shqiptare.

Mësimet bëheşhin në serbokroatish, më vonë do të mësonte greqishten e vjetër, latinishten, frëngjishten e rusishten, por gjuhën e vet, atë me të cilën do të lidhej në jetë të jetëve gjithë qenia

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

e tij, ishte i detyruar ta mbante në trurin e tij, në vetmi të plotë.

Bashkë me gjuhën mbante të gjitha shkëndijimet, që në vend t'i zbeheshin, përndriteshin edhe më shumë nga largësia, malli dhe sidomos pamundësia.

Por të gjitha këto u rritën në një shkallë të re gjatë pesë vjetëve të studimeve të tij fetare në seminar. Mund të thuhet pa e tepruar se kjo ishte një antishkollë e vërtetë për të. Në vend të devotshmërisë ndaj fesë ajo do t'i nxiste përcëmimin ndaj saj, në vend të përvuajtjes, krenarinë, në vend të mospërfilljes për gëzimet e jetës, etjen për to, madje në skajshmërinë e tyre, atje ku feja sfidohej më vdekshëm: mëkatin, erotizmin gjer në incest etj., etj.

«Mos u lut për mua, se dua pash më pash ti bij ferrit, shkruan në një nga vjershat e tij. Për mendësinë e një fetari Milloshi i ri, në mos ishte vetë djalli i veshur me robe seminaristi, kishte bërë së paku një pakt me djallin për t'u joshur (tani për tani), nga gjithçka e ndaluar, makabre, shkatërrimtare. Ai përfytyron gjëra të tmerrshme: fusha që në vend të grurit pjellin tyta të hekurta topash, uraganë që thyejnë statuja idhujsh, varre, gurët e të cilëve lartësohen gjer në qiell, popuj të tërë që llahtarisen ndër këmbët e hapura të një përbindëshi, kufoma fëmijësh që propozohen të dhurohen si shtatore, shtatore që pjellin fëmijë etj., etj. Çdo gjë që mungon, gjithçka e ndaluar, e mallkuar, e shpallur jashtë

ligjit dhe moralit, bëhet e afërt për shpirtin e tij.

Kështu duhet t'i ketë lindur edhe dashuria për letërsinë atje në seminarin e mërzitshëm sllav, si dashuri për atë që mungon. Dhe është e kuptueshme se ndërsa letërsia atje mungonte, përgjithësisht për letërsinë shqipe as që mund të bëhej fjalë. Përsëri, si përmes një velloje èndrrash, ndoshta këtë herë më e dendur se ajo e Tivarit, do t'i kenë ardhur fytyrat e poetëve e shkrimtarëve shqiptarë, ashtu siç mund t'i kishte parë në librat e shkollës në fëmininë e tij. Fytyrat e tyre të çuditshme, me rrudha kërcënuese, me sy delirantë që dukej sikur pérherë kérkonin të të besonin një kumt misterioz, disa herë kishin mbi supe zhgunganin e thjeshtë të murgut, por shpesh ishin mbësh-tjellë me rroben e sundimtarit, me pelerinë peshkopi, xhube rektori, grada, armë ose frak diplomati. Kështu i kishin edhe fatet disa herë të jash-tëzakonshëm, të pabesueshëm. Ja njëri prej tyre, një bashkëqytetar i tij, autor i një prej poemave më të njobura të letërsisë shqipe, i vjershës së burkur, aq të pikëllueshme, aq lirike, «O moj Shqipni, e mjera Shqipni», që gjithë vocërrakët e Shqipërisë e mësonin përmendësh në shkollë, pasi kishte botuar vjersha të shkruara në italisht në Venedik, pasi kishte botuar shkrime anglisht në Londër dhe pasi kishte botuar romanin e tij të vetëm të shkruar në frëngjisht në një shtëpi botuese të Parisit, kishte ndërruar fenë katolike në mysli-mane, kishte braktisur letërsinë për karrierën dhe që emëruar prej sulltanit turk si guvernator i Li-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

banit. Dhe kështu kishte vazhduar të jetonte me dy emra, një katolik e një mysliman, me dy fama, atë të poetit në vendin e tij e atë të diktatorit në vendin tjeter, së fundi me dy fate pas vdekjes: i glorifikuar te shqiptarët si rilindas, i zi te libanezët si tiran.

Sa të largët, të huaj e mizorisht të fuqishëm duhet t'i jenë dukur Migjenit këta shkrimtarë, ftyrat e të cilëve në orët e mërzitshme të mësimeve fetare duhej t'i përziheshin me ato të personazhevë biblike. Por, i dukeshin ose jo të tillë, e joshnin ose e tromaksnin, ai do të hynte në aradhën e tyre, në atë urdhër të rreptë e të zyrtë që kërkonte ndoshta flijime më shumë se çdo urdhër fetar.

~~Kështu, Milloshi e mbaroi seminarin si një antiseminarist. Ai po dilte nga porta e tij për t'i kthyer shpinën përgjithmonë klerit dhe zhgunit priftëror. Për sytë e një fetari të devotshëm, Migjeni dilte nga seminari ortodoks sllav si një djall me tre brirë. Ai ishte një dezertor i fesë. Ai donte të behej shkrimtar. Ai donte të behej shkrimtar shqiptar.~~

Ishin triakuza të mjaftueshme për ta vënë në kryq.

Migjeni u kthyte nga Jugosllavia nëpërmjet rrugës automobilistike veriore. Ndonëse nuk ë di më me saktësi itinerarin e plotë të saj, as ndalesat apo kohën që zgjati udhëtimi, e marrim me mend se kjo rrugë duhej të kishte qenë delirante për të. Dhe kjo, jo për arsyet e peizazheve, vende-vende danteske, as për mallin që e kishte marrë për qytetin e lindjes, por pikërisht për atë shkëputje që po ndodhët në jetën e tij: Kishte vdekur priftëria për t'ia lënë vendin një pasioni dehës: letërsisë.

Atë e priste Shkodra, qyteti që ai e donte aq shumë, që malli i ndarjes dhe ditët e mërzitshme të seminarit ia kishin zbuluar edhe më shumë në kujtesë. Shkodra e bukur, mëkatare, me rrugët, portat, oborret plot mister, me tregtizat, kafenetë, prostitutat, me kambanaret, minaret, pro-cesonet, erotizmin e fshehtë, me bisedat pas dardke, mondanitetin, lypësat, inteligjencien, çmen-durinë.

Ky ishte qyteti që ai e donte «me një dashuri tragjike», po të përdorim një shprehje të tij. Shkodra ishte parajsa dhe ferri i tij. Shkodra, dashunorja e qiellit të kaltër... e liqenit èndërtar në të cilin, ne mengjeset të kullueta lan hijen e vet». Kështu do të shkruajë për të kur do ta scdisë që larg. Dhe më poshtë: «Këtu në kët' largësi ndiej damarët e saj që rrahin, rrahin e rrahin... edhe sikur mjeku që tharpton fytyrën kur shef se patienti i tij ka ethe q'ashtu edhe unë pezmato-hem n'idhним tue pa se pulsi i dashnores seme nuk rreh sic duhet».

Kështu, pra, ai po rendte drejt kësaj Shkodre të kthjellët e të ngrysur, të dashur e të padashur, për t'u zhytur në të përfundimisht, èmbësisht, tragjikisht, në ekstazën e saj pranverore nga njëra anë, në ferrin e saj nga ana tjetër (as'kishte shkruar «pass më pass dua t'i bie ferrit?»), në bukurinë dhe shëmtimin, në madhështinë dhe rënien e saj.

Përparrë tij do të shfaqeji së shpejti qyteti që do t'i jepet brumin për veprat e tij. Turbull, ai e ndien se në jetën e tij bashkë me pasionin e ri po hyn një tehuazim, një mosmarrëveshje, një drame e re. Gjer tani kjo ka ndodhur me fenë dhe me mjesidin e huaj sllav. Dhe ishte njëfarësoj më e qartë dhe më e lehtë për t'u zgjidhur. Kurse një mosmarrëveshje me të vetët do të ishte shumë më e vështirë.

Që larg duket kështjella e famshme dymijë-vjeçare, e cila në legjendën e saj të zymtë të in-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

terpretueshme në shumë mënyra, ka dominuar jo vetëm fantazinë e tij, por një pjesë të letërsisë shqipe... Njëra nga tri nuset e tre vëllezërve që ndërtojnë urën do të murohej e gjallë, ndryshe ngrehina nuk qëndron... Flijim bestyd, apo krim i përllogaritur?

Ngrehu nuse t'u çosh bukë mjeshtërve!...

Janë fjalët e vjehrrës që i dërgohen nuses së parë, pastaj të dytës në mëngjesin fatal të mürimit. Por të dyja kane gjetur një arsyë të mos binden. ngaqë e dinë c'kob i pret. Nusja e tretë, me e reja, që s'di asgjë, niset drejt flijimit.

Ngrehu Migjen të shkosh te letërsia shqipe...

Nuk është fantazi e sëmurë e gjithë kjo Prej kohe ai e di se fjalët «letërsi» e «flijim» janë të afërtë, sidomos në Shqipëri.

Për shkak të rrethanave e ka ëndërruar këtë letërsi disi nga larg. Tani që u afrohet portave të saj të rënda, që dëgjon kërkëllimën e zinxhirave të tyre, turbull e ndien se ka diçka që është vjetëruar në këtë letërsi. Ka lexuar gjithfarë librash e autorësh që nga Shën-Agostini te Niçja, nga Dostojevski te Sinkler Ljuisi, nga ekspresionistët gjermanë te shkrimtarët socialistë, ndaj është e natyrshme të dyshojë se mos makina e letërsisë klasike shqipe nuk është në gjendje të funksionojë mirë për kohën e re. E ndien se ajo ka nevojë për riparim, për risi, kjo makinë e rëndë që ka kaluar nëpër kaq prova tragjike dhe që mund të dëmtohet tani pikërisht nga epizmi i saj.

Si çdo krijues i madh, ngaqë ndien peshën e

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

tij, ai ndien njëkohësish peshën e rrezikut. Një botë e tërë mund të ngrihet kundër artit të tij. Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, ai e ndien, gjithashtu, se me këtë botë kundërshtuese do të komplotojë një pjesë e atij vetë: sëmundja e ftizisë, fatalitet i kohës, që jep herë pas here shenjat e saj të para. Ndjesia e një afati, e një afati brenda të cilit duhej të kryhej vepra e tij, ajo perde funebre që do të nxisë herë më pranë e herë më larg në horizont të jetës së tij, i jep një ngutje dramatike gjithçkaje.

Turbull ai i ndien e i parandien të gjitha këto, ndaj dhe në vjershën e famshme «Kangët e pakëndueme» shkruan për veprat e tij:

«Unë djep i juaj e ndoshta varri i juaj»

Priftëresha e Orakullit të Delfit nuk mund të jepte një parathënie më të dykuptimshme. Në të dy rastet ajo ishte e vërtetë: Migjeni u bë në njëfarë mënyre varri i veprës së vet, meqenëse sa ishte gjallë pjesa kryesore e saj mbeti e pabotuar. Por nuk do të kalonte shumë kohë që vepra e tij do të botohej e do të bëhej e famshme, kështu që shumë shpejt varri do të mposhtej prej djepit.

Të gjitha këto, në një mënyrë ose në një tjetër, ai i kishte në trurin e tij, ndërsa kthehej në atdhe. Përpara tij ishte qyteti që ai do ta zberthente fije për fije në laboratorin e tij prej shkrimtarë. Kambanaret, minaret e tij shkëlqenin me një rrëzëllim kërcënues që larg. Mirë se vjen, në ke ardhur për të mirë, për ndryshe...

Ai nuk vinte për të mirë. Dhe ai e dintë sa e

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

rrezikshme ishte kjo. Sepse ky qytet ishte mbi dy-mijëvjeçar dhe hijen, dhe fyterjen, dhe zemërimin e kishte të rëndë. Po jo më pak të rënda i ka të gjitha këto shkrimtari që vjen.

Milloshi i ri duhej të kalonte ditë vërtet të lumtura në Shkodrën e tij. Vendimi për t'u ndarë nga bota e fesë është kaq i prerë saqë ai, me gjithë dashurinë e madhe që ka për të njojur botën e madhe, do të refuzojë edhe studimet në Oksford, vetëm e vetëm se fakulteti që i propozohet është ai i teologjisë.

Studenti i kthyer në shtëpi nuk vinte nga ndonjë qytet i madh evropian plot zhurmë dhe ditë, për të sjellë në provincën e humbur nostalgjinë për «dritat e qytetit të huaj». Përkundrazi, ai vinte nga një qytet i prapambetur i Ballkanit dhe, për më tepër, nga një shkollë tejet e mërzitshme.

Në krahasim me atë qytet, Shkodra ishte qendër e madhe e plot jetë. Një nga qytetet më të lashtë të krejt gadishullit, bashkëkohëse e Romës antike, kryeqytet i mbretërve ilirë, Shkodra, me

gjithë furtunat që i kishin kaluar përsipër, e ruante ende peshën dhe hijen e saj. Hijen e pushtetit të dikurshëm të padronëve të saj, derës së famshme feudale të Bushatllinjve, shpatëndëshkuese e sultانëve në krejt Gadishullin Ballkanik, madje më larg gjer në Hungari e në Kretë, hijen e fesë katolike, kuvendet e kishat e së cilës nuk ishin më pak të fuqishme, dhe së fundi hijen e maleve, atë hije të rëndë tragjike që me mijëra kanale e udhë misterioze zbriste nga Malësia e Madhe, nga Bjeshkët e Namuna, nga krejt rrafshi verior i Shqipërisë për të plotësuar, për të zëvendësuar apo për të korrigjuar diçka në statusin shpirtëror të këtij qyteti.

Por nuk ishin vetëm këto. Përveç kështjellës dhe kishave, përveç kullave, kambanareve dhe minareve, Shkodra kishte jetë kulturore, biblioteka, arkiva mesjetare, zyra konsujsh, revista letrare që shpërndaheshin në të gjithë vendin. Ajo kishte intelektualë, sallone ku fliteshin e diskutoheshin gjithfarë problemesh, gra të bukura me histori të ndërlikuara dashurie, dyqane ku shiteshin libra, disqe e perfume të Parisit, aventurierë, skandale, maniakë nga ata që pjell qytetërimi etj., etj.

Një njeriu të zakonshëm, të ardhur nga qyteti ortodoks i Manastirit, Shkodra do t'i dukej fillimi i Evropës. Por Migjeni, ndonëse i ri, kishte tjetër vizion për botën dhe të tjera pika referimi. Qytetin e vet të lindjes, atë qytet që mahnistë dhe mallëngjente dhjetëra poetë e shkrimitarë të

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

kohës, shumë shpejt ai e gjeti të prapambetur, të mërzitshëm e plot pikëllim.

*Mbi kështjellt' mijvjeçarë qëndrojnë sorrat e smueme,
Krahët i kanë varë pa shpresë simbojt e shpresave të humbuna,
Me klithma të dëshpërueme bajnë fjalë për jetë të prendueme,
Kur kështjellat mijvjeçare si xhixha shkël-
qejshin të lumtuna.*

Kjo është piktura e pamëshirshme që djalo-shi njëzetecavjeçar i bën kohës së vet.

Të tjerë shkrimitarë e poetë, pasi enden në-për Romë e Paris, kthehen në Shkodër dhe syri i tyre jo vetëm nuk sheh asgjë për t'u pikëlluar, por përkundrazi sheh vetë gjëra të mrekulluesh-me: kopshte të veshura me shermashék, vegime stinësh virgjine, burra me qokë e malësorë kresh-nikë që zbresin nga malet, vajza si zana, që mund t'i kenë zili edhe hyjneshat greke, e kështu me radhë, e kështu pafundësisht, poshtërsisht, mizo-risht.

Me përcëmim të thellë duhet t'i ketë lexuar Migjeni këta «të mallëngjyer», qofshin për tre-gun e Shkodrës apo bezistanin e Elbasanit, për pazarin e Tiranës apo ranishten e Durrësit. Duke e dashur vendin e vet, pa asnje dyshim duke e dashur thellë, madje pikërisht për shkak të kësaj dashurie, ai e quante të pamoralshme të mbyllte

sytë përpara mizerjes dhe amullisë në të cilën kishte mbetur ky vend.

Të gjithë kombet po dehen n'epopena të veta, flakë e zjarrmit të tyne na i përzhitit ftyrat, dhe nëpër to një nga një po shtohen rrudhat, e nën kambë e mbi krye tinëz po na hikë jeta.

Migjeni ishte kundërshtues i pamëshirshëm i cdo lloj konformizmi në art. Ngaqë i dhimbset vendi i tij, ai është kundër idealizimit të tij, ngaqë do përparimin e vendit, ai është kundër traditave të ngrira, euforisë, krenarisë boshe kombëtare, keto kanxha që e mbajnë të mbërthyer Shqipëri-në në vend dhe nuk e lënë të bëjë hap përpara.

Atika hyrë rrugës se letërsisë, por arti që do të bëjë ai është ndryshe nga të tjeret. Ndryshe për çdo gjë dhe në cdo gjë. Në zgjedhjen e motiveve, në shtiellimin e tyre, ne mesazhin filozofik që kumtojnë, ne stilin, teknikën e të shkruarit, gjuhën. Ai ndahet kështu vetveti nga një grumbull i madh shkrimitarësh të kohës me një prerie prej humnere. Ndarja e tij s'ka asnjë shtysë abuzive, etje për t'u dukur, dalди sallonesh letrare, kënaqësi sfiduese, revansh, larje llogarish personale etj., etj. Ndarja e tij është në logjikën e gjërave, është në themel të artit të tij, në gjithë strukturën dhe në çdo qelizë të këtij arti. Letërsia e tij kështu ka lindur si një gjë e veçantë, një gjë «tjetër lloj».

Në valixhen e studentit ka sjellë me vete **ca**

Ardhja e Sigjenit në letërsinë shqipe

vjersha, ca fragmente poemash e prozash që s'ia ka treguar ende askujt. Letërsia klasike shqipe, kjo strukturë hijerëndë epike, i duket prapë e largët. Por jo më pak të largët i ngjajnë shumica e shkrimitarëve të kohës, veprat e të cilëve, mendimet, polemikat, grindjet e platformat po i përpin me ngut, i etut për t'u futur sa më shpejt në klimën letrare të kohës.

5

Në të vërtetëjeta letrare e viteve 20 e 30 në Shqipëri ishte mjaft e pasur dhe interesante. Siç ndodh shpesh me kohërat e zhgënjimeve, kjo epokë, si për drejtpeshim të gjérave, duke qenë shterpë në gjithçka, jepte letërsi të madhe.

Peizazhi letrar ishte sa i larmishëm, aq edhe i ndërlikuar. Si në të gjitha regjimet tiranike, pra edhe në mbretërinë shqiptare, shkrimtarët zyrtarë e gjysmëzyrtarë, mbështetësit e drejtërdrejtë ose të tërthortë të regjimit, avokatët, përligjësit e shtypjes, të prapambetjes e të krimit, i ndeshje kudo. Konformizmi (të cilin disa prej tyre më vonë nën trysninë e historisë ose të vrasjes së ndërgjegjes do të rrekeshin ta përligjnin) ishte gjithsesi i papërligjshëm. Ai mund të ishte i tillë vite më parë, kur Shqipëria pas një ndërprerje pesëqindvjeçare u bë rishtas shtet më vete (në fund të fundit ky është shteti ynë, le të mbyllim

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

sytë përpara të metave të tij, mezi e krijuam, dreqi e mori, ta durojmë sa të mëkëmbet). pra, konformizmi mund të kuptohej vitet e para të kaosit, vitet e para të daljes në dritë kur ende në sytë e porsaçelur vazhdonte ëndrra kombëtare, iluzionet, magjepsja, shpresat. Mirëpo tani kur të gjitha këto kishin marrë fund, kur mbretëria arkaike si prej operete e kishte zgjedhur vendosmërisht rrugën e saj të amullisë e të shtypjes, konformizmi ishte, as më shumë as më pak, një prostitucion letrar.

Ky ngjante edhe më tepër i tillë për faktin se këta shkrimtarë nuk kishin ndonjë detyrim për t'u konformuar ndaj tiranisë mbretërore.

Ka diktatura të tmerrshme e djallëzisht të përsosura ku profesioni i shkrimtarit është një mallkim i vërtetë. Në kësi rendesh të frikshme, vetë të qenit shkrimtar përbën një faj e një fatkeqësi fillestare (primordiale) të pakorrigjueshme më e të ngjashme me gjymtimet, nga ato për të cilat njerëzit ofshajnë «pse më linde, moj nënë!»

E keqja më e madhe për shkrimtarin në kësi rastesh është se me t'u njojur ai si i tillë, asnje mundësi nuk ka më për t'u kthyer pas, me fjalë të tjera për t'u tjetërsuar. Është bërë shkrimtar në një kohë të papërshtatshme, në një orë të ligë, si i thonë fjalës, nga dashuria për artin, ngaqë ka besuar në një ide, në një iluzion etj., etj., shkaqet s'kanë rëndësi. Rëndësi ka që tani ai s'ka më asnje mënyrë për të ndrequr diçka, goftë edhe duke e shkatërruar vetveten. Ka paguar, si të gjithë, një

taksë të parë, taksën e të qenit shkrimtar, absolutisht e detyrueshme në kësi rendesh, ka bërë, pra, një lëshim të parë, që i është dukur ndoshta i lehtë, në krahasim me atë zjarr që e djeg së brendshmi, pasionin e të shkruarit. Por më pas, kur e ka kuptuar se taksa sa vete rëndohet, se do të jetë i detyruar të paguajë përherë e të bëjë përherë lëshime gjer në mbarim të ditëve të tij, kur e ka kuptuar, pra, këtë, me një tmerr akoma më të madh, ka kuptuar gjithashtu se të gjitha rrugët për ta braktisur këtë punë janë të myllura, dhe se ai fatalisht ka vetëm një zgjidhje: të vazhdojë të jetë shkrimtar. Është përjashtuar luksi i heshtjes, sepse mekanizmi i diktaturës i rri vazhdimisht mbi kokë për ta bërë të flasë, dhe e tmerrshme është se është përjashtuar protesta dhe vetflijimi i shkrimtarit, sepse diktatura, duke qenë djallëzisht e përkryer, e nuhat e para këtë, ndoshta më parë se vetë shkrimtari, dhe i merr masat për ta zhdukur atë fshehtësisht përparrë aktit të protestës ose të vetflijimit. Ajo e kryen, pra, zhdukjen fizike të tij, për ta varrosur të nesërmën me nderime e për të vazhduar kështu të shfrytëzojë veprën e tij. Edhe në rastet kur shkrimtari arrin t'i shpëtojë syceltësisë së rendit dhe të kryejë vërasjen, ajo do të quhet thjesht një aksident (shkrepje pa dashur e armës, rrëzim nga ballkon). Madje edhe në rastin kur shkrimtari do të ketë shansin ta kryejë protestën ose vetshkatërrimin e tij aq publikisht saqë të jetë e vështirë të mbulohet, diktatura e ka rrugën e zgjidhjes: ajo

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

do të falsifikojë shkaqet e vërteta të aktit, do të sajohet një histori sentimentale, ose një sëmundje (zakonisht kancer), që gjoja përshpejtoi fundin e njeriut. Dhe pastaj ironia e fundit: do të ndryshohet letra e tij e lamtumirës, e cila nga një klithmë urrejtje kundër tiranisë do të kthehet në një përgjërim dashurie e mirënjoshe ndaj saj në orën e ndarjes.

Vetëm një mrekulli mund të bëjë që në tiranitë e tilla, shkrimtari t'i shpëtojë këtij kalvari. Për fatin e mirë të letërsisë shqipe tirania e mbretit Zog nuk ishte e tillë. Së pari, sepse ajo nuk ishte aspak djallëzisht e përsosur. Së dyti, sepse si një mbretëri e re, me një fron legjitimisht të dyshimtë, e tallur dhe e sulmuar nga kundërshtarët politikë, ajo ishte ende në periudhën e përligjies së gjërave, e kërkimit të pajtimit kombëtar, shkurt, ajo ishte ende një tirani difensive, në qoftë se mund të përdornim një term të tillë.

Ishte e qartë se në një tirani të tillë s'kishe asnjë detyrim për të qenë konformist. Mbreti Zog, me një zgjuarsi të hollë, të trashëguar nga elita osmane, në disa raste ua kishte bërë të qartë krijuesve që nuk e donin se ai jo vetëm nuk kérkonte prej tyre ndonjë zell, por ishte gati t'u shpërbente heshtjen. Kështu që konformizmi i kalemxhinjve të kohës, sado që disa prej tyre deshën ta përligjnin më pas, ishte thjesht pjellë e ndërgjegjes së tyre të zvetënuar.

Për fat të mirë, kjo turmë servilësh, sic ndodh zakonisht me kësi turmash, shquhej për

mungesë talenti e për një mediokritet të sigurtë.

Një korpus tjetër, disi më serioz e autoritar, ishte ai i shkrimtarëve reaksionarë, që edhe duke mos qenë himnizues të regjimit, madje duke patur, për arsyet të ndryshme, pakënaqësi e brengatndaj tij, në llogari të fundit me artin e tyre i shërbënин atij. Këta ishin kryesisht disa nga shkrimtarët klerikë katolikë të Veriut, qofshin të drejtimit tradicionalist (himnizues të patriarkalizmit, të kanunit shekullor, të ngrirjes muzeale të Shqipërisë), qofshin të drejtimit modern (idhtarë të evropianizimit të vendit, por që me këtë të fundit nënkuptionin fashistizimin e tij, ngaqë për ta Evropa niste e mbaronte te Italia musoliniane).

Grupi tjetër i shkrimtarëve, që në mënyrën më të skajshme e më pa kompromis i qe kundërvënë letërsisë zyrtare e reaksionare, ishte ai i shkrimtarëve të rinj përparimtarë, kundërshtarë të tërbuar të shtetit e të regjimit, me ide të reja përparimtare e disa herë socialiste, për një shqëri të re e një art të ri.

Përfat të keq, kjo aradhë luftarake, një pjesë e së cilës u grupua rreth revistës «Bota e re», kishte një mospërkim midis ideve tepër të përparuara e forcës artistike jo të mjaftueshme, që e dobësonte aksionin e saj kundër asaj makine të organizuar aq mirë e me autoritete të spikatura, sic qe letërsia reaksionare.

Grupime të tjera më të vogla gjëllonin midis kësaj ndarjeje të madhe. Poëtë rilindas të vonuar, që si gjithë të vonuarit ishin të vakët e të pane-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

vojshëm, idhtarë të artit për art, shkrimtarë feta-
rë myslimanë, poetë sentimentalë, mistikë, parna-
sienë, ndjekës të Niçes e të Frojdit, dramaturgë
klasikegjantë, subjekti më i afërt i të cilëve vinte
gjer në vitin 1500 etj., etj.

Midis këtij trazimi të jashtëzakonshëm, që
shtohej prej dhjetëra gazetave e revistave letrare,
që shkumëzonin nga polemikat dhe pasionet, dy
shkrimtarët më të mëdhenj të kohës, Fan Noli e
Lasgush Poradeci, qëndronin krejtësisht jashtë
rriymave, madje të vecuar edhe nga njëri-tjetri.
Të tjerë shkrimtarë të shquar bënин pjesë, kush
më shumë e kush më pak në këto grupe. Shkrim-
tarë dhe kritiku i ri Dhimitër Pasko, me pseudonimin
~~Mitrush Kuteli~~, i tërhequr gjithashtu më-
njanë, në novelat e tregimet e tij piktoronte një
Shqipëri eterne, me një bukuri të butë, as të
idealizuar, as të përcmuar, me arin e vjeshtës e
brymën dimërore, me hënë, lugetër, magji, erë ka-
shte e pikëllim muzgu. Midis kësaj tabloje ende-
shin personazhe disi të çuditshme, nganjëherë
poetike, por më tepër groteske. E përshkruar nga
një dorë mjeshtri, e gjithë kjo botë ishte krejt
mospërfillëse ndaj Shqipërisë zyrtare, thua se ajo
nuk ekzistonte. Ishte ky një përfitim i ndërgjegj-
shëm apo i pandërgjegjshëm i shkrimtarit për të
treguar se Shqipëria e përjetshme s'kishte gjë të
përbashkët me këtë botë e këtë mbretëri të për-
kohshme? Vështirë se mund ta thuash. Vepra e
Paskos, ashtu mospërfillëse edhe e mënjanuar nga
tallazet politike, mund të merrej si një vepër për-

parimtare, sipas gjykimit, tashmë të përhapur gjerësisht, se një vepër e shkruar bukur, ishte objektivisht kundër një regjimi reaksionar ose një diktature, formulë kjo tepër komode për mjaft shkrimitarë, por njëkohësisht fort e pëlqyeshme për çdo rend tiranik, sepse çdo rend tiranik, në vend të goditjes së rrebeshit, do të parapëlqente atë «të bukurisë».

Ndër shkrimitarët reaksionarë veriorë, Ernest Koliqi i drejtimit proevropian (d.m.th. proitalian), ishte shembulli tipik se si një talent mund të writej nga përqafimi i ideve fashiste. Zgjedhja e gabuar e kampit politik, që e coi dalëngadalë nga simpatia e parë për fashizmin në postin e ministrit të qeverisë kolaboracioniste, ishte fatale për të.

Ndërsa Koliqi botonte novelat e tij plot me personazhe moderne, të rinj që ktheheshin nga studimet jashtë shtetit, që filozofonin nëpër kafenetë e Shkodrës se si mund të modernizohej ky vend pa fyer sentimentet e të vjetërve (Migjeni do të nervozohej e të shfrynte veçanërisht kundër këtij predikimi), një tjetër personalitet, madje më i njoburi e më i reklamuari, i kurorëzuar si poet kombëtar, prifti Gjergj Fishta, në vetminë e kuvendit të franceskanëve po rrekej të krijonte një vepër që ishte sa jashtë kohe, aq dhe jashtë mundësive të tij. Ai orvatej të thurte poemën e madhe totale, ku të mblidhë krejt eposin shqiptar në shembullin e mbledhësit mesjetar të Nibelungëve, të epeve të tjera evropiane, madje edhe

më thellë, të epeve homerike. Absurde si ndërmarrje, për arsyen që merreshin lehtë me mend, ajo bëhej dyfish e tillë për shkak se poetit françeskan i mungonin shumë gjëra, e në radhë të parë ai talent i veçantë për të përpunuar, apo më saktë për të vënë nën fre, atë shkumëzim të lirë, magjepsës e me bukuri befasuese, herë parajsore e herë inferiale të eposit verior. Në vend të atij tèrbimi ai nxori nga pena poemën e gjatë monotonë «Lahuta e Malcisë», një kronikë sterile, e cila duke qenë, veç të tjerash, moralizuese e didaktike, ngjante me epët e veriut aq sa ç'mund të ngjante ujët e distiluar me ujvarat e bjeshkëve.

Në këtë poemë, që u shpall e në të vërtetë ishte «vepra e jetës së tij», himnizohej Shqipëria e prapambetur, kanunore e mesjetare. Në kërkim të një të vërtete të përjetshme të kombit, ç'ka do të kushtëzonte dhe universalizmin e prezentuar prej tij në poezi, ai nuk shkoi më tej konfliktit ndëretnik midis shqiptarëve e sllavëve, që e shpalli si një luftë gati kozmogonike. Në të vërtetë, ndeshja kishte qenë e vazhdonte të ishte e egër, si çdo ndeshje shekullore, madje e tillë që dëshmuar edhe në eposin shqiptar, i cili vazhdonte të këndonte kundër sllavëve, ndonëse kishte vite që shqiptarët po ndesheshin me një armik të ri: osmanët. Kjo luftë e re nuk kishte sjellë asnjë modifikim në epos, ç'ka tregonte se për eposin mijëvjeçar turqit ishin një valë kalimtare, kurse kobi i vërtetë ndaj racës shqiptare vazhdonin të mbeteshin sllavët, parandjenjë ogurzezë kjo

që u vërtetua më 1913 kur kombi shqiptar u shqye tragjikisht më dysh (shqyerje që rrjedh ende gjak sot), pikërisht për shkak të sllavëve.

Kështu ishte në epos. Por, me gjithë nderrimin për epikën popullore, letërsia e kultivuar ngrihej gjithmonë mbi të. Nuk i lejohej një poeti, e aq më tepër një poeti të shekullit XX, që të mos shihte në këtë kob asnjë dritë e asnjë rrugë pajtimi, madje as aq dritë sa jepte herë-herë vetë eposi zemërak. Aq më pak nuk i lejohej një poeti që duke dhënë tablo tronditëse të kësaj ndeshjeje dhe duke u revoltuar me të drejtë ndaj padrejtësive që i qenë bërë e vazhdonin t'i bëheshin kombit shqiptar, të mos bënte, megjithatë, një dallim midis popujve sllavë dhe shovinizmit sllavomadh e sidomos atij serbomadh. Mendjet më të ndritura në Ballkan, qoftë nga ana shqiptare, qoftë nga ana sllave, e kishin bërë ndërkaq këtë dallim. Ngjarjet e mëvonshme (madje edhe ato më të fundit, për të përmendur një tragjedi të vonë siç që ajo e viti 1989, kur slovenët e kroatët u ngriten në mbrojtje të shqiptarëve të Jugosllavisë e kundër shovinizmit serb), do të ishin, veç të tjerash, një rideshmim i këtij dallimi.

Mesazhin nationalist të Fishtës, mesazh që herë-herë merrte përmasat e një ksenofobie totale e që synonte izolimin e plotë të Shqipërisë prej botës së jashtme, nuk e përfilli as letërsia e as mendësia shqiptare, çka vërtetonte se ato kishin arritur ndërkaq që shkallë të tillë emancipimi, që i bënte të mos binin në zona të ulëta të shoviniz-

mit, goftë edhe kur ato parashtroheshin nga një poet i shpallur kombëtar, e goftë të shprehura me një poetikë hijerëndë e mjeshtërore, siç qe përmbledhja «Mrizi i zanave», vepra më e arrirë artistikisht e tij.

Në dyluftimin me kulturën shoviniste serbe, shumë personalitete të së cilës nuk njohën asnë kufi në vjelljen e vrerit kundër shqiptarëve, kultura shqiptare u tregua dukshëm superiore. Ashtu sikurse kodi zakonor u ndalonte rreptësisht shqiptarëve masakrimin e viktimës, ashtu edhe kultura shqiptare nuk pranoi kurrë të përdorte kundër sllavëve të jugut mjete poshtëruese që iu propozuan nga drejtime të ndryshme, siç qe, p.sh., prejardhja e hamendësuar e emrit «serb» nga fjalë latine *serpens* (gjarpër), aq më tepër që ajo kontrastonte bujshëm me emrin shqiptar të prejardhur nga *shqiponjë* e të tjera si këto.

Siç ndodhët shpesh me krijimet që kanë vullën e nacionalizmit, vepra e Fishtës, e sidomos «Lahuta e Malcisë» fitoi një popullaritet të veçantë, goftë në rrethet zyrtare, sidomos ato proitaliane e më pas kuislinge, goftë në shtresat e prapambetura e disa herë analfabete të popullsisë, të cilat nuk ishin në gjendje të kapnin thelbin e saj, por e njihnin atë pjesërisht si një zinxhir episodesh. Afria e saj me poezinë popullore e shkrirja disa herë me folklorin, ndihmuani që ajo të mësohej lehtë përmendësh, çka u interpretua prej idhtarëve të tij si vërtetim i suksesit.

Në të vërtetë, me gjithë mosqasjen e ftohtë-

sinë që treguan për të shkrimtarët e intelektualët e shquar shqiptarë, veprës së Fishtës, sidomos «Lahutës së Malcisë», iu ngrit një kult e iu bë një reklamë e tillë, saqë rrezikonte ta kthente atë në një gur varri që mund t'i merrete frymën gjithë letërsisë shqipe. Dukuri jo fort të shpeshta, vepra të tilla (të një autorë, të një grupi autorësh ose të një drejtimi letrar), qëllon që shfaqen në letërsi të ndryshme, tamam si sëmundje që duhen kapërcyer. Për fat të mirë, letërsia shqipe, për shkak e rrethana jashtëletrare (çlirimi i vendit nga fashizmi, përbysja shoqërore etj.), u çlirua më shpejt se ç'pritej nga ky keqkuptim.

Gjergj Fishta vdiq në vitin 1940, kur vendi ishte në kulmin e zisë së robërisë, kurse ai vetë në majën e një lavdije, përndritja e së cilës ngjante ogurzezë në sfondin mortor fashist. Varrimi i tij i organizuar me madhështi nga qeveria kuislinge shqiptare, nga kleri katolik vendas e nga Vatikani i Romës, ishte njëkohësisht varrimi i një epoke në letërsinë shqipe.

Ndryshe nga Fishta, Ernest Koliqi arriti ta shihte me sy dramën e vet si ndjekës i fashistëve. Pas kapitullimit të tyre ai iku bashkë me ta në Itali, ku vazhdoi të shkruajë duke i shtuar veprës së tij një epilog të trishtueshëm. Në një nga veprat e tij, dramën «Rrënjet lëvizin», botuar në Romë më 1967, veprimi i së cilës ndodhte në të ardhmen diku në mes viteve '70, ai parashikonte përbysjen e rendit komunist në Shqipëri, rihapjen e kishave dhe udhëtimin atje të vajzës së tij

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

si turiste, fill pas vdekjes së të atit dhe pikërisht ditën kur kambanat e kishave, pas heshtjes tepër të gjatë, po gjëmonin përsëri në Shkodër. Nga të dy parashikimet u krye vetëm njëri: vdekja e tij, që ndodhi vërtet në vitet shtatëdhjetë.

Fare i ndryshëm nga të gjithë këta, një personazh tjeter i kohës, Faik Konica, vazhdonte veprën e tij. Një nga shqiptarët më me kulturë të gjithë kohërave, *arbiter elegantiarum* i letrave shqipe, sipas Fishtës, njeri me parashikime kandriane, sipas Nolit, hipokondriak fin, sipas Apolinerit, luan i letërsisë e i diplomacisë, sipas një komplimenti të bërë në sy prej mbretit Zog, Faik Konica ishte vërtet një figurë e pazakontë. Mjafton vetëm larmia e formimit të tij kulturor, bëdhjet dhe ikjet nga një universitet në tjetrin, për të hedhur njëfarë drite mbi karakterin dhe kundërtitë, që do ta shoqërónin tërë jetën këtë vesveseli të pashoq. Si shumë bejlerë myslimanë, e kishte nisur kulturimin me mësues privatë të arabishtes, që i braktisi për të shkuar në kolegjin katolik të jezuitëve në Shkodër, prej nga, si për të plotësuar koleksionin e feve, shkoi në shkolën ortodokse greke, e pas saj, në Liceun imperial në Konstantinopol. Prej andej, krejt i pakënaqur, shkoi në Francë për t'u bërë murg protestant, por në vend të murgërisë përfundoi në ateist, për të vazhduar studimet e larta në Paris, e më pas me radhë në universitetet e Kembrixhit në Angli, të Upsalasë në Suedi e të Havardit në SHBA.

I pajisur me një mendje sa brilante, aq edhe të mbrapshtë, që s'e kishte për gjë sot të shfaqte dhimbsurinë e nesër të tallej mizorisht me vendin e vet, aristokrat tipik i artit, që në sallonet letrare të Londrës e të Parisit e ndiente veten si në shtëpinë e vet, që kishte aq intuitë sa të parashikonte të ardhmen e Gijon Apolinerit e të bëhej mecenat i tij, në kohën që aq shkrimtarë shqiptarë (aq shumë shkrimtarë shqiptarë të druajtur e belbanë), do të kishin nevojë për përkrahjen e tij, Faik Konica, ky tigër i trishtuar i botës shqiptare, përbuzës e rrenimtar, stilist i shkëlqyer, polemist e sfidant i lindur, në prozën e tij të llojit gogolian, si te romani i bukur, mjerisht i pambaruar, «Doktor Gjilpëra», aty dëshpërohej e binte në zi përvendin e tij, aty e quante Zululand, e përcmonte e shqyhej gazit me të. Në qoftë se ironia e tij do të ishte si dash i ftohtë përkundër idealizimit reaksionar fishtean, kjo do të kishte një kuptim, por e qeshura e tij ishte herë-herë cinike. Nga një pjesë e veprës së tij lexuesi kishte përshtypjen se vinte një tallje therëse: shikojini shqiptarët, duket sikur thoshte në ato faqe plagosëse, shikojini këtë don kishotë të trullosur, kanë krijuar shtetin e tyre e s'dinë ç'të bëjnë me të!

Kështu, si duke qeshur e duke u tallur, ai pranoi të bëhej ambasador i mbretërisë shqiptare në SHBA, pra ambasador i atij mbreti kundër të cilët s'kishte lënë gjë pa thënë në mbledhje, në shtypin e kohës e në darkat e tij luksoze me miqtë. Më vonë, pas përmbysjes së monarkisë, kur edhe

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

atij i erdhi ora e shqyrtimit të ndërgjegjes, në librin «Shqipëria, kopsht graniti në juglindje të Evropës», botuar në vitin 1941, pak kohë para vdekjes, u përpoq të përligjte aktin e tij duke shkruar se ai qe bërë ambasador jo i monarkut, por i kombit të vet, një pohim për të cilën historia ende s'e ka thënë fjalën e saj. Këtu, veç duhet shtuar, se ai ishte ndoshta i vetmi ambasador në botë që nuk vinte asnjëherë në atdhe, ngaqë ishte i sigurt se, në rastin më të parë, mbreti do ta helmonte, gjë që s'përjashtohej.

Të tillë ishin shkrimitarët e shekullit XX në Shqipëri, të ngjashëm në njëfarë mënyre me personazhet e pazakontë të letërsisë **së mëparshme shqipe**. Jo më **pak** të **ndërlikuar** e befasues në gjithçka ishin edhe dy **shkrimitarët** më të mëdhenj të epokës: **Lasgush Poradeci** e **Fan Noli**.

I pari **Lasgush Poradeci**, «ky poet me leshra të verdha si teutonët», sic e quajti në fillim kritika konservatore, për të gjetur te ngjyra e flokëve të tij (që në të vërtetë s'ishin fort të verdha), një shenjë tjetër që dëshmonte largimin e artit të tij nga tradita, pasi kishte kryer ose lënë përgjysmë një numër shkollash e universitetesh në vende të huaja, për t'u doktoruar më në fund në Universitetin e Gracit të Austrisë, pasi kishte studiuar kështu për letërsi, arte, gjuhësi, filozofi, pikture e misticizëm, koleksionist si Konica edhe ky, e kishte plotësuar serinë e gjuhëve të huaja edhe me sanskritishten, për t'u kthyer më në fund, pas njëzet vjet studimesh, në atdhe, i brohoritur si një

nga poetët më të shkëlqyer të vjershërimit shqip. Ajo që i mahnitit të gjithë, më shumë se flokët e tij, ishte përdorimi virtuoz i gjuhës shqipe e i teknikave poetike të saj, që ai i çoi gjer në përkryerje, duke qenë në shumicën e kohës jashtë shtetit, e duke i plotësuar studimet e tij «të zgjatura» në disa gjuhë, por asnjëherë në shqip.

Gjiganti tjetër i letrave, Fan Noli, pasi kishte kryer, gjithashtu, ca punë jo fort të zakonshme në rininë e tij (mbarimin e shkollës fillore në gjuhën greke në Turqi, mësimin e muzikës bizantine te kryekëngëtar i katedrales greke në Adriano-pojë, sufler i trupave endacake teatrore, kopjuet dramash në një teatër të Athinës, aktor dhe **këngëtar kishe në Egjipt etj.) kishte shkuar në Boston të SHBA për t'u bërë në fillim prift e për t'u regjistruar pastaj në Universitetin e Havardit. Pas kësaj qe tërhequr nga letërsia, por kishte menduar se në një vend si Shqipëria misionin e poetit mund ta kryente më mirë po të siguronte një titull të lartë fetar. Arriti të bëhej kështu kryepeshkop i Shqipërisë, por edhe kjo nuk e kënaqi. Që ta zgjidhte përfundimisht punën mendonte se duhej të përbyste kryeministrin Zog, mbretin e ardhshëm, e të merrte pushtetin. Për të përgatitur shqiptarët, por më shumë veten e vet përkëtë përbysje, përktheu dramat e Shekspirit «Makbethin», «Hamletin» dhe «Jul Çezarin». Pas kësaj, e përbysi vërtet tiranin dhe u bë kryetar i qeverisë, por duke mos qenë po aq i zoti si kryeministër, siç qe si shkrimtar, e humbi pushtetin**

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

pas gjashtë muajsh, i përbysur prej Zogut. I arratisur e i dëshpëruar pas dështimit të aventurës së tij shekspiriane, meqenëse përkthimi i kryeveprave kishte hyrë tashmë në jetën e tij, në mërgim kishte nisur përkthimin e «Don Kishotit», dëshmi kjo e qartë se në fund të ndërgjegjes së tij gjente një ngjashmëri me kalorësin e vrengosur.

Ndonëse në pamje të parë të pangjashëm në asgjë me njëri-tjetrin, pikërisht një simetri e kundërt i lidhte këta dy «monstres sacrès» të letrave shqipe.

Lasgush Poradeci, në kulmin e famës së tij poetike, mospërfillës për punët e mbretërisë e të shoqërisë, «zog i qiejve», sic e kishte shpallur veten në një vjershe, vështronë që nga lartësia poetike botën duke shkruar herë pas here vjersha të një bukurie të mahnitshme për mbarimin e vjetës, për dashurinë, pavdekësinë, pelikanët, ndjekjen e yjeve e gremisjen e tyre në abys.

Fan Noli, përkundrazi, demon i përbysur vërtet në humnerë, dërgonte që anët vjershat e tij tronditëse, një pjesë e të cilave ishin për rrëzimin e tij, që ai e njëjësonte, jo pa të drejtë, me rrëzimin e ëndrrës së demokracisë në Shqipëri. Në vjershat me motive biblike ai e njëjësonte, gjithashtu, veten me Krishtin e kryqëzuar, ashtu sic gjente ngjashmëri midis darkës së Krishtit e mbledhjes se fundit të kabinetit të tij të ministreve, disa prej të cilëve me qëndrimet e tyre ndaj kryeprofetit (kryeministrat) të kujtojnë vërtet

personazhet e dishepujve të Jezuit, që nga shën Pjetri e gjer te Juda Iskariot.

Noli e Poradeci, ky kon i dyzuar me njërën majë lart e tjetrën poshtë, sundonte letrat shqipe, sepse për lexuesin shqiptar, që të dy poetët, si i bekuari, si i mallkuari, ishin njëlloj të njojur e të dashur.

Kjo ishte në vija të përgjithshme tabloja e jetës letrare shqiptare kur në horizontin e saj, i druajtur e i pavërejtur, u shfaq Migjeni. Askush nuk mund ta kuptonte atëherë se ai do të zinte vendin e vet si i barabartë midis dy më të mëdhenjve të kohës, Fan Nolit e Lasgush Poradecit, dhe midis pesë shkrimitarëve më të mëdhenj të krejt letërsisë shqipe.

Ishte një djalosh i veshur me kostum të kohës, i hajthëm, trup mesatar ashtu si qindra djem të tjerë që ndeshje në atë kohë në Shqipëri. Pamja e tij,jeta që bënte, gjithçka tjetër e tij (me përjashtim të asaj ç'ka shkruante), do të shkaktonë një zhgënjim të plotë te lexuesi shqiptar, i cili qe mësuar që t'i përfytyronte shkrimitarët e vet si qenie të madhërishme e groteske, ç'ka dhe ishin vërtet në shumicën e rasteve. Ja bashkëkohësi i tij Noli, ajo natyrë që dukej se do ta përmblidhëte e ta qefësonte vetëm varri, pas aventurës së tij mbretpërbysëse, pas rënies në dëshpërim, që herë-herë e shëronte, përvèç vjershavë që shkruante, me përkthimet e Edgar Poes, Verlenit e Bodlerit, në moshën pesëdhjetëvjeçare mbaronte konservatorin e muzikës në Nju-In-

gland, SHBA, e afër të gjashtëdhjetave merrte doktoratën në Universitetin e Bostonit. E, sikur të mos ishin mjaft të gjitha këto, sikur të mos i mjaftonte njohuria e shkëlqyer e të gjitha gjuhëve të mëdha evropiane, si të mos i mjaftonte si kureshti gjuha persiane, që e kishte mësuar vetëm që të shijonte në origjinal Omar Khajamin, në pleqéri i vihej studimit të hebraishtes, për leximin në origjinal të librave të shenjta, (ashtu siç kishte bërë Lasgush Poradeci me sanskritishten për të lexuar në origjinal Vedat hindiane), por edhe për një qëllim tjetër: të hulumtonte ngjashmérinë midis shqiptarëve e çifutëve, një ide pasionante e rinisë së tij që i qe rikthyer në fund të jetës.

Tjetri, Poradeci, natyrë po aq e pasur dhe e ndërlikuar, prapa maskës së serenitetit të jashtëm, kishte arritur që intimitetet erotike të jetës së tij t'i kthente në një koleksion brilantësh poetikë ndër më të ndriturit në letërsinë shqipe. Në moshën tetëdhjetëvjeçare (Migjeni kishte kohë që kishte vdekur), ai kishte ende aftësinë që jo vetëm të përjetësonte por edhe ta konvertonte në poezi e këtë herë edhe në prozë të shkëlqyer («Vizitat e zonjushës X.Y. në kullën time») një pasion të fundit të jetës së tij të gjatë.

Migjeni nuk ishte i kësaj race. Me sa dukej në letërsinë shqipe që mbyllur koha e personalzheve të tilla fantastike. Dhimitër Pasko (M. Kutteli) ishte i fundit, në fatin e të cilit u përsërit diçka nga tradita groteske. I mobilizuar rastësisht

në trupat rumune «Kryqet e hekurta», ai ishte ndër shqiptarët e rrallë për të mos thënë i vetmi që iu afroa Stalingradit si oficer i ushtrisë gjermane. Për habinë më të madhe u kthyte i gjallë që andej, dhe meqenëse si ekonomist ishte po aq i shquar në mos më tepër se si shkrimtar, u emërua nëndrejtore i Bankës Kombëtare. Duke qenë në këtë post kaq delikat, u lidh megjithatë me rezistencën dhe në prag të ikjes së gjermanëve arriti t'u dorëzojë forcave partizane çelësat e thesarit shtetëror, duke shpëtuar grabitjen e tij të plotë prej nazistëve. Kështu, të nesërmen e çlirimt të vendit, me gjithë aventurën e tij stalinogradase, u gjet midis shkrimtarëve të rinj shqiptarë, madje u zgjodh edhe në kryesinë e Lidhjes së Shkrimtarëve të porsathemeluar në shtetin e ri komunist. Një udhëtim në Jugosllavinë aleate, si pjesëtar i një delegacioni zyrtar të Lidhjes, delegacion që u prit me nderime prej Ivo Andriçit etj., ishte fatal për të. Me kërkesën e jugosllavëve, të nesërmen e kthimit në Shqipëri, u arrestua, ngaqë, me sa dukej, gjatë udhëtimit diçka kishte folur për çështjen e Kosovës, gjë që jugosllavët nuk ia falnin askujt. Për fat të tij marrëdhëniet kështu që u lirua nga burgu pa mbushur dy vjet nga kjo, në vitet e mëpastajme, shkroi tepër pak e më shumë u mor me përkthime, duke dhënë në shqip me një mjeshtëri të përkryer disa nga kryeveprat e letërsisë botërore.

Një vezullim fare i fundit i gjesteve epikogroteske ishte dueli që, sipas një thashethemi të përhapur në kryeqytet, Lasgush Poradeci i kërroi më 1946 ministrit të Kulturës të qeverisë komuniste, pas një fyerje që ky i fundit i kishte bërë poetit në shtyp. Fyerja, merret me mend, qe bërë nga pozita të majta, ndonëse ministri vetë u dënuar më pas për djathtizëm, hollësi e dorës së dytë kjo, përparrë faktit që ky ishte i vetmi ministër komunist në botë që thirrej në duel nga një poet, në një vend ku pushteti komunist ishte në fuqi c'prej dy vjetësh, çka tregonte se te poettët shqiptarë vazhdonte ende një venë marrëzie heroike.

Ishte mbyllur, pra, koha e personazheve të tillë, njëlloj si në eposin e kreshnikëve, ku heronjtë e tij të fyer rëndë prej shpikjes së armëve të zjarrit e braktisin dheun, ku iu duket se nuk kanë më vend, për të zbritur në zgafellat e errëta.

Por edhe sikur koha e trillevë të mos ishte në muzg, vështirë se Migjeni do të ekte nëpër hulinë e saj. Ai ishte vërtet tjetër lloj. Nuk kishte as xhup peshkopi, as frak e cilindër, as njohje gjuhësh të jashtëzakonshme (lexonte përvèç serbokroatishës, frëngjisht dhe rusish), as historira zhurmëmëdha dashurie. Në krahasim, p.sh., me skandalin e bujshëm të Lasgush Poradecit, i cili nga aeroporti i Tiranës në atë të Romës, e më tutje nëpër Budapest e Hagë, kishte ndjekur, pa e arritur dot, një vajzë holandeze, të sjellë prej tij

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

në Shqipëri, e të larguar, me sa dukej, pa lejen e tij, skandal që Migjeni me siguri e ka dëgjuar në Kafen e Madhe të Shkodrës, ashtu siç ka dëgjuar që kjo rendje me aeroplani nëpër qill, është kthyer në poezinë e Poradecit në rendje e ndjekje yjsh, që e dashurojnë por nuk e arrijnë dot njëri-tjetrin, në krahasim, pra, me histori të tillë që përgojoheshin nga gjithë bota, dashuria e Milloshit për zonjushën B., një kushërirë të tij, ishte një histori krejt diskrete, ndonëse tragjike në thjeshtësinë e saj. Jo më pak e tillë duhet të ketë qenë dhe përvoja tjetër e tij, vajtja në një shtëpi publike gjatë një udhëtimi në Athinë, dhe heqja dorë në çastin e fundit nga tundimi për të provuar dashurinë me një prostitutë.

E thënë shkurt për një lloj mendësie shqiptare, për atë lloj mendësie të prapambetur sidomos që vinte që nga kohërat antike e që shikonte te poeti jo vetëm poetin, por njëkohësisht magun, njeriun e ritiit me cilësi të pazakonshme e të veshur me njëfarë pushteti që vettetiu e ndjell ri-
ti, Migjeni ishte thjesht «një civil».

Por pikërisht ajo që në pamje të parë mund të dukej si mungesa e tij, përbënte forcën e vëçantë të tij. Migjeni ishte vërtet një civil. Ai vinte në letërsinë shqipe si shkrimitar i tipit të ri, shkrimtar qytetar me një kurajë të re, që ishte ende pak e njojur në këtë vend, por aq shumë i duhej atij: kurajo civile.

Si i tillë, duke patur përkime me bashkëko-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

hësit e tij të mëdhenj, Nolin dhe Poradecin, në disa gjëra, ai ndahej në mjaft të tjera. Por ai ndahej sidomos nga letërsia tjetër shqipe, ajo zyrtare e reaksionare, me të cilën ishte në polemikë e në kundërshtim të vazhdueshëm.

Ai ishte kështu një poet marxhinal. Të vëtmuar ishin edhe Noli me Poradecin, madje t>për të vëtmuar, por vëtmia e Migjenit, ajo vëtmi e thjeshtë, e pabujshme e tij, ishte më tragjikja e të gjithave.

Atij i kishte munguar vërtet xhubja e poetit mag, rroba e peshkopit apo fraku i dendit, ashtu siç i kishte munguar përvoja dhe pasuria jetësore e bashkëkohësve të tij të mëdhenj, përndezja mesianike e Nolit që e kishte ndier veten herë misionar të Krishtit, herë vetë Krishti, herë të kryqëzuar, herë triumfator, apo dehja qiellore languardiane gjatë rendjeve të tij pas «holandezë fluturuese» etj., etj. Por në qoftë se Migjenit i kishtë munguar të gjitha këto, edhe atyre u kishte munguar ai bosht tragjik i rinisë së tij, ai bosht ulëritës, por që ishte i atyre llojeve që natyra u afron disa herë shkrimitarëve në vend të pasurisë jetësore, u afron, pra, në vend të pasjes, mungesën, por të tillë që mund të pjellë të njëjtat brillante, në mos disa herë më të ndritura.

Së fundi duhet thënë se Migjeni nuk arriti të kishte tjetër jetë veç rinisë së tij, dhe ne duke thënë «rinia e Migjenit» kemi thënë në të vërtetëjeta e tij. Sepse, si për të shtuar një dallim të fu-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

ndit të tij prej shkrimtarëve të mëdhenj shqiptarë,
të cilët veç Naim Frashërit, qëvdiq në moshën 54-vjeçare, jetuan mjaft gjatë (Noli i kapërcen të 80-at, kurse De Rada dhe Poradeci arritën të 90-at), Migjeni vdiq në moshën 27-vjeçare.

6

Migjeni shkroi dy vepra kryesore, «Vargjet e lira», në poezi, dhe «Novelat e qytetit të veriut», në prozë. Asnjëra prej tyre nuk e pa dritën e bontimit në gjallje të tij. E para u ndalua prej censurës mbretërore, të dytën, ai vetë nuk arriti ta cojë në ndonjë shtëpi botuese. Ai arriti të botojë ndërkaq në shtypin letrar periodik disa nga vjershurat e tij si dhe disa proza të shkurtra, që i ka quajtur herë-herë «novelëza», dhe që mund të cilësohen edhe ashtu, por që në shumicën e rasteve, siç ndodh shpesh me artin e madh, i shpëtojnë çdo cilësimi.

Meqenëse vepra e Migjenit është përgjithësisht një dyluftim i pambarim me një pjesë të letërsisë dhe jo vetëm të letërsisë, por të krejt mendësisë shqiptare, ajo mund të kuptohet saktësisht vetëm e ballafaquar me to.

Siç u tha edhe më parë, Migjeni erdhi në le-

tërsinë shqipe në kohën e zhgënijimit të madh. Shqipëria porsa kishte dalë nga nata islamiko-osmane. Dalja e saj, përmes një kaosi e anarkie të paparë, kishte qenë një ndër më të dhimshmet në historinë e shteteve. Kufijtë e prerë sipas një kirurgjie të pamëshirshme dhëmbnin ende. Gati gjysma e shqiptarëve kishte mbetur jashtë tyre. Vendi ishte i varfër, i trishtë, gjysmë i rrënuar. Në krahasim me èndrrën e shumëpritur, zhgjëndra ishte një traumë e vërtetë.

Sikur të mos mjaftonte kjo, shteti i vogël ballkanik, pasi njoihu një periudhë të shkurtër drite e demokracie, qeverinë e Fan Nolit, ra prapë nën një tirani arkaike, atë të mbretit Zog. Procesi i atrimit të Shqipërisë me vendet e zhvilluara evropiane u ndërpren. Siç duket, pesë shekuj puthimi osman nuk kapërceheshin kaq lehtë. Dukej sikur, ndërsa tërhiqej prej Shqipërisë, Perandoria e ndryshkur Osmane i kishte lënë vezët e gjarprit në këtë vend. Dhe ato e dhanë shumë shpejt rrjedhojën: me gjithë lustrën gjoja evropiane, mbretëria e Zogut nuk ishte vecse një projektim i monarkisë orientale, dhe ai vetë, një sulltan i vogël, siç u cilësua prej poetëve.

Ngjante vërtet si një lojë e fatalitetit që, pas pesë shekujsh lufte kundër një errësire, të mos gjejë dot një tjetër model qeverisjeje veç hijes së saj. Me sa dukej, nuk ishte aq e lehtë, siç që dukur më parë, lamtumira me Azinë.

Shqiptarët kishin arsyë të ishin të traumatizuar. Më saktë se çdo dëshmi tjetër, gjendjen

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

dëshpëruese të tyre e jepte kjo frazë anonime, që qarkulloi në atë kohë nëpër libra, fjalime, vjersha e biseda: «Shqipëria u bë për të plasur shqiptarët».

Si do të vejë halli i këtij vendi, q'do të bëhet me këtë komb. Shteti u krijua, po a mund të bëhen shqiptarët shtetas? Kur do të marrë fund kjo varfëri, kjo prapambetje, ky mallkim!

Këto ishin pyetjet që bëheshin kudo në shtyp, në kafene, pas darkave.

Shqipëria, kjo «Zonjë e randë», e fyer prej të huajve, romakëve, sllavëve, turqve, tani ishte më e turpëruar se kurrë, ngaqë fyerja po i vinte prej vetë shqiptarëve. Mjerimi, injoranca, korrupzioni, zyrtarët e paaftë, të vrисnin sytë kudo. Duke u tallur me ministrat injorantë të qeverisë, në vjershën e dëgjuar «Sulltani dhe kabineti», Noli shkruante:

*Ti Halim që s'di këndim,
Bëju vezir për arsim.*

Njerëzit me të drejtë pyesnin: a s'ka shqiptarë të aftë për të qeverisur punët? Librat janë mbushur me portrete personazhesh të tillë në të kaluarën. Nga dituria, universitetet, gradat dhe doktoratat e tyre të merren mendtë. Ku humbën tani që i duhen aq shumë vendit?

Ata që i kuptonin punët më thellë heshtnin. Sepse ata e dinin që e gjithë kjo ishte në logjikën e sundimit tiranik. Një sundimtar dinak si Zogu;

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

ashtu siç do të qëmtonte kudo zyrtarët e paditur e të pazotë, me po atë zell, në mos më tepër, do të përpiquej të zhdukte ose së paku të neutralizonte të zotët e të talentuarit.

Të tjerë intelektualë, me mendjen e trullo-sur nga leximet e përsiatjet, ëndërronin shfaqjen në Shqipëri të «Mbinjeriut» nicean. Së paku ky, i ftohtë e i pamëshirshëm, siç qe, (ndërgjegje pa dyshime, siç e cilësonte Migjeni në vjershën e famshme «Trajtat e Mbinjeriut»), do të mund ta shkulte mykun që ngjante i pashkulshëm; pastaj të bëhej q'të bëhej. Të tjerë mendonin zgjidhje të tjera, disa herë radikale e disa herë fantaziste.

E gjithë kjo pasqyrohej njëfarësoj në pjesën më të përparuar të letërsisë shqipe. Toni i saj ishte i zymtë, për të mos thënë i përzishëm. I vrenjtur ishte Noli, por jo veç përfatim e vet. I pagueshur ishte Poradeci, ndonëse në pamje të parë mund të mos ngjante i tillë. Po ta lexoje më kujdes do të hetoje se mbi prarimin e lodhur të brilantëve të tij poetikë, nxinte aty-këtu hija e vdekjes. Akoma më i vrenjtur ishte Migjeni. Madje zymtia i shkonte atij më shumë se të tjerëve. Por si në çdo gjë, edhe në vrenjtje ishte ndryshe. S'e kishte ngrysjen mistiko-luksoze të Poradecit, as vrerosjen demoniakë të Nolit. Pezmi i tij ishte i tipit të ri, ai pezm, në dukje i rëndomtë, ishte më i fuqishmi i të gjithëve: pezmi qytetar, civil.

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

**VJESHTË NË NATYRË DHE VJESHTË
NDËR FTYRAT TONA**

Me këtë varg ai e nis vjershën e famshme
«Vjeshta në parakalim».

*Ngjyrët e verdha lozin në vallen e fundme,
(Dëshirë e marrë e gjetheve që një nga një
vdesin),
Gëzimet, endjet tona, dëshirat e fundme
nëpër balta të vjeshtës një nga një po shkelin.*

Dhe më poshtë:

*Një lis pasqyrohet në lotin e qiellit,
Tundet dhe përgjaket në pasjon të viganit,
«Jetë! Jetë unë due! e frymë merr prej fellit,
si stuhi shkymë ajrin... por në fund ia nis vajit.*

Ishte e kuptueshme se për tiraninë zogiste, ashtu si për çdo tirani, një gjendje e tillë shpirtërore në art ishte krejt e papëlqyeshme. Në vënd të saj ajo do të donte euforinë, ngjyrat rozë, himnet dhe tamburatë festive, të cilave nuk mungonin t'u binin letrarët lajkatarë, servilët dhe gjithë zhgani tjetër i prostitutave letrare. Nuk ishte e rastit që një nga revistat reaksionare të kohës, «Leka», ankohej kundër zymtësisë së disa intelektualëve dhe bënte thirrje: «për gazmendje».

Por turma e lajkatarëve nuk përbënte ndo-

një rrezik serioz për letërsinë shqipe. Amoraliteti i tyre dukej që larg. Një tjetër aradhë shkrimtarësh, me radhë më të ngjeshura e me dukje më serioze, përbënte një kurth të vërtetë për letrat shqipe. Këta ishin shkrimtarët që euforinë ndaj regjimit mbretëror e kishin zëvendësuar në vepren e tyre me një eufori tjetër, mitin e kombit të zgjedhur, që ndonëse tashmë i kishte kaluar koha, e kishin ringjallur dhe përpinqeshin ta bënin motiv të parë të aksionit intelektual shqiptar. Me këtë gjellë të ftohur, e cila në kohë të Rilindjes kishte shërbyer si ushqim shpirtëror, përtë zgjuar shqiptarët e për t'i bërë të ndërgjegjshëm për identitetin e tyre, ata ishin sulur të lustronin e të pudrosnin një realitet të trishtë. Por si çdo gjellë e vjetër ajo ishte jo vetëm e padobishme, por tejet e rrezikshme. Euforia kombëtariste, himnizimi i traditave, i kanuneve mesjetare, ekzaltimi gjer në mekje prej «virtuteve të racës»: burrërisë, besës, kultit të nderit etj. përbënин tani një proces reaksionar e frenues. Ato ishin një maskë për të mbuluar fytyrën e vërtetë, tepër të trishtë të realitetit shqiptar, një drogë për të mpirë ndjeshmérinë e artit ndaj tij. Së fundi, një barrierë mjaft e gjetur kundër gjithë ideve të reja shoqërore që rrezikonin shpërbërjen e rendit mbretëror të mykur e jashtë kohe si rrallëkush.

Përballë euforisë dhe vetëlëvdatave prej të cilave po i merrej fryma artit shqiptar, Migjeni dhe shkrimtarë të tjerë të kohës i parashtruan

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

botës shqiptare një vizion të ri: sensin vetëkritik.
Nuk ishte e lehtë që një vendi ballkanik, me një histori aq dramatike, t'i propozoje një sens të tillë. Ai sens do të ishte shenjë e sigurt e emancipimit të mëtejshëm, shenjë pjekurie dhe kulture e kombit.

Edhe më parë në letërsinë shqipe ishte dukur aty-këtu ky sens, por ai kishte qenë i rrallë. Kurse tani ai ndihej përherë e më shpesh e me përmasa të mëdha, si te vjersha e famshme e Nolit «Moisiu në mal» ku parashikimi i zymtë i Jehovajt:

*Skllevër bij skllevërish s'e meritoni
se liri s'doni*

shpallte fajin kolektiv të popujve për gjendjen e tyre.

Qortimet, qoftë edhe shfritmet dëshpëruese si ky i Nolit, nuk kishin gjë të përbashkët me përcëmimin cinik. Ato ishin gjithë dhembje, ngaqë ishin të gatuar prej saj.

*Në vendin tonë
Kudo valojnë
flamujt e një melankonie
të trishtueshme...
... dhe askush s'mund të thotë
se këtu rron
një popull që ndërton
diçka të re.*

Është vjersha «Nën flamujt e melankonisë», një tablo antifestive e pakompromis dhe që s'kursen askënd me të cilën mbyllët libri «Vargjet e lira» i Migjenit. Vjersha u shkrua në prag të festimeve të 25-vjetorit të pavarësisë së vendit, jubile që mbreti Zog po e shfrytëzonte për reklamimin dhe përjetësimin e dinastisë së tij. Në sfond të flamurëve të festës Migjeni ka ngritur flamurët e vet të përzishëm.

Koha nuk ishte për festë. Shqipëria ishte në terr e mjerim. Mjerimi i saj ishte ulëritës, i padurueshëm, «kafshatë që s'kapërdihet», siç e quajti ai në vargun e parë të «Poemës së mjerimit». Përballë këtij mjerimi ekonomik e moral, të gjitha himnet, kapardisjet, mburrjet për «fisnikërinë e racës» etj., tingëllonin si një farsë makabre.

Populli, i shpallur dikur si një ndër më fisnikët e Europës, pasardhesi i ilirëve, madje sipas disave i pellazgëve mitikë (e origjinën pellazgjike nga ajo hyjnore nuk e ndanin vecse dy hapa!), ngarky popull i zgjedhur, pra, i ngjante tani një armatë të rreckosur të dalë nga një makth.

Sytë e tij janë prapë të veshur e të turbullt, por jo nga robëria, nga tjetër gjë: nga keqkuptimi i gjérave. E Migjeni dëshiron ta zgjojë nga ëndrra e mbrapshtë. Kështu titullohet edhe një «zgjimi», një nga formulat poetike kryesore të Rilindjes, te Migjeni ka kuptim të ri, madje në njëfarë mënyre të kundërt me atë të tyre. Zgjohu, të kuptosh se sa i fismë je, këndonin ata,

kurse thirrja e Migjenit ishte e ndryshme: zgjohu që ta kuptosh se sa i mjerë je.

Sfida e Migjenit s'ka të bëjë vetëm me institucionet gjysmëqesharake të regjimit, të cilat s'ishte fort e vesh tirë të ironizoheshin, sfida shkonte më thellë, kishte të bënte me «malin që s'bëzan», pra me krejt mendësinë shqiptare, me idolet, kanunet, mitet, komplekset e paragjykimet të shtresuara shekull pas shekulli e të kthyera tashmë në një lëvozhgë të ngurtësuar mbi të cilën mund të thyenin kohën idetë përparimtare dhe të gjitha formulat e reja që mund t'i para-shtroheshin këtij vendi prej mendjeve më të emancipuara të tij.

*O si nuk kam një grusht të forte
ti bij mu në zemër malit që s'bëzanë*

Kështu shkruan Migjeni në vjershën «Recital i malësorit» që është në radhë të parë recital i tij.

Ç'të bëjë një poet kundër një «mali që s'bëzan?» Dhjetë vjet më parë Noli e kishte përmbytur shtetin tiranik. Por «mali që s'bëzan» ishte më i fortë se çdo shtet.

Ashtu sikurse «zgjimi», në poetikën shqiptare «malet» kishin qenë një nga formulat më sublime. Ata ishin simboli i qëndresës, i pastërtisë, i mosdhunimit, i ruajtjes së gjuhës, zakoneve, i vëtmisë krenare. Por në kushtet e pavare-sisë, pra, në kohën që shoqëria shqiptare s'priste

ndonjë gjë prej maleve, ato s'ishin veçse simboli i ngrirjes e i prapambetjes. Nuk ishte e rastit që tradicionalistët qenë kapur me thonj e me dhëmbë pas kreshtave të tyre. Ora e Maleve, Komiteti i Maleve, Lahuta e Malcisë. Me dhjetëra ishin vjershat, gazetat, shoqatat që vazhdonin të himnizzonin malet, në kohën që Migjeni, fare i vetmuar midis këtij kori, lëshonte një thirrje të re.

*Mali hesht dhe në heshtje që sh
e unë vuej e në vuejtje vdes.*

Është hera e parë që në poezinë shqiptare malet përftohen si një forcë malefike (hera e parë pa dyshim në qoftë se nuk do të llogarisnim të vetmin zë të dikurshëm, një klithmë të lashtë, misterioze, që ishte shuar e ngurrosur në një emërtim, «Bjeshkët e Namuna», me të cilën pulli kishte quajtur një pjesë të tyre).

Kështu Migjeni i brishtë, djaloshi i krehur me kujdes, korecënimi i të cilit do t'i bënte të shqy-heshin gazit banorët e maleve, goditi i pari atë që ngjante e paprekshme. Ai goditi tradicionalizmin reaksionar në disa pikë të shenjta sic qenë «virytet e racës» me të cilat abuzohej dinakërisht. Një mendësi e tërë kanunore e mesjetare i kishët shpallur koncepte të tillë, si burrnia, nderi, besa etj., si rruaza të gjerdanit të saj arkaik. Duke i përfthuar ato jashtë çdo konteksti shoqëror, i idealizonte e u thurte himne e bindur që kishte gjetur në të një arsenal të paçmuar në luftën e saj ku-

ndër përparimit dhe emancipimit të njeriut shqiptar.

Ky vizion metafizik nuk lejonte asnjëherë të bëhej pyetja: «burrni» po në emër të kujt e në shërbim të kujt?

Dhe dihej se trimëria shqiptare, ashtu si përgjithësia trimëria ballkanase, i kishte shërbyer po aq punëve të mbara sa edhe të mbрапshta.

Më 1453, kur në kulmin e betejës për pushtimin e Konstantinopolit prej turqve, një ushtar shqiptar me emrin Ballaban, qe ngjitur i pari mbi murin rrethues (për ç'ka qe shpërblyer me gradën e gjeneralit), ky ishte edhe fillimi, së paku për mesjetën, i atij vargu të gjatë bëmash e gjestesh të shqiptarëve, që shërbenin në ushtritë e huaja të shtyrë kryesisht prej karrierës.

Me qindra gjeste «burrnore» ndodhnin çdo ditë në malet shqiptare këtë herë nga një shtysë tjetër, që ndonëse ngjante fisnike e kavalereske, ishte krejtësisht absurde: shtysa e gjakmarrjes.

Të tjerë shqiptarë turreshin drejt trimërisë të shtyrë, ashtu si dhe ballkanasit e tjerë, nga etja për t'u dukur, për t'u lëvduar në këngë (një shpërblim tepër i ëndërruar ky që vinte që nga kohërat homrike), nga kokëkrisja natyrore, nervozizmi ose kapardisja.

Të gjitha këto, të kënduara në këngë e balada, ushqimi kryesor shpirtëror i njerëzve, riprodhonin vetveten, ngaqë frysmezonin gjeste të reja, e kështu vazhdonte ky rrëth vicioz prej nga shqiptarët dukej se nuk do të dilnin dot kurrrë.

Gjithë ky univers trimëror, bashkë me kodin, zakonor (nganjëherë nuk kuptohej mirë ku mbaronte njëri e ku niste tjetri), së bashku me origjinën ilire, për të cilën ata vazhdonin të ishin vëçanërisht krenarë, e fqinjët e tyre veçanërisht xhelozë, së bashku edhe me parapëlqimin që kishte perandoria në radhë të parë për ta, e pas tyre për grekët e çifutët për t'i vendosur në poste të larta (a nuk ishte familja shqiptare e Qyprillini, ve, për 400 vjet rresht familja më e fuqishme pas asaj të sulltanit?), të gjitha këto, pra, në një mënyrë ose në një tjetër kishin krijuar te shqiptarët ndjenjën e superioritetit. Që ballkanasve s'u vininte ndonjë gjë e mirë nga komplekset, qoftë ai i superioritetit, qoftë i kundërti i tij, i inferioritetit, kjo për fat të keq nuk ishte fort e qartë (ende sot vazhdon ngandonjëherë midis tyre gara fatkeqe dhe mburrja mendjelehtë se cilët prej tyre e kanë drejtuar perandorinë). Por së paku, në ndryshim nga kompleksi i inferioritetit, që pillte urrejtje të nuk krijonte veç mospërfillje, që mund të shkonte gjer në përbuzje ndaj të tjerëve, por pa krijuar asnjëherë psikoza kriminale (kujtoni qëndrimin gati të përgjithshëm ndaj ciganëve).

Shqiptarët, si ballkanas të vërtetë, kishin trashëguar prej stërgjyshërve të tyre ilirë disa nga kokëkrisjet e mburjet e tyre, që të kujtonin kokëkrisjet e mburjet e grekëve të vjetër. Ata e quanin veten më trimat e më të virtytshmit e të gjithëve. Nga fqinjët, me përjashtim të grekëve,

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

që ua pranonin trimërinë, por u qortonin përdorimin e thikës, armë e pabesë sipas mendësisë shqiptare, ata i nënçmonin të gjithë, e sidomos maqedonët e serbët dhe më pak malazestë, ndoshta ngaqë u vinte mirë që imitoheshin prej tyre. Për popujt e tjerë me të cilët kishin patur përkritje në raste luftërash, ata kishin nënçmim të përgjithshëm për turqit, mosnderim për italianët në punë trimërie e mungese serioziteti, por një butësi ndaj tyre megjithatë, kurse mendonin se të vetmit që u afroheshin për guxim e seriozitet ishin gjermanët.

Etja për t'u dukur, për të fituar lavdi në kuvenç ose në log të burrave ishte e përbashkët te tërë ballkanasit, por të shqiptarët dhe grekët ajo kapërcente çdo kufi, madje besohej me të drejtë se ishin këta, që bashkë me epikën dhe kodet e lashta, u ngjitën popujve të tjerë, të ardhur më pas në gadishull. edhe këtë sëmundje.

Dëshira për t'u dukur, shfaqeji fare qartë edhe te veshja. Shqiptarët, me gjithë «varfërinë e tyre heroike» (Heroischen Armut, siç e ka quajtur një prift gjerman), si burrat, si gratë kishin veshjet më të bukura e luksoze në krejt gadishullin e madh. Kujdesin e tyre të pazakontë për pamjen e dëshmonin konkurret e bukurisë së burrave në male, ose kërcënimet e papës drejtuar grave se nuk do të varroseshin si të krishtera nëse «nuk hiqnin dorë nga zakoni i patenzonë i modës».

Në gjestet trimërore. dukja, paraqitja dinji-

toze, nuk harrohej kurrë, aq sa ngjante e zakonshme kërkimi i një krëhëri në çastin përpara ekzekutimit prej të dënuarit me vdekje, në mënyrë që të vdiste i bukur, ose lutja e fundit për të mos i shëmtuar fytyrën, drejtuar xhelatit, ose zogjve të shkretëtirës në rast vdekje gjatë shërbimit ushtarak.

Kompleksi i superioritetit, me gjithë anën e vet donkishoteske, ose më saktë, pikërisht për anën e vet donkishoteske, ishte i dëmshëm, në radhë të parë, për vetë shqiptarët. Që ai nuk i nxiti ata kundër kombeve të tjera, kjo u duk qartë në vitet 30 e 40, kur propaganda gjermane, e bazuar, me sa duket, në gjithë traditën e «vendit të shqiponjave», që shkenca gjermane e kishte studiuar më mirë se gjithë të tjerët, diku më haptas e diku më tërthorazi, nisi të bënte fjalë për superioritetin e racës shqiptare. Një joshje e tillë, ndonjëse lidhej me disa probleme themelore kombëtare si çështja e kufijve etnikë etj., nuk i tërhoqi aq sa pritej shqiptarët dhe kjo do të ketë krijuar me siguri zhgënjim te gjermanët. Me përjashtim të një elite, që shpresonte se në Rajhun e 3. shqiptarët (ose më saktë kuadrot shqiptarë), do të kishin po atë status të privilegjuar si në Perandorinë Osmane, të ndonjë rryme progjermane në kulturë e të romantikëve nacionalistë që nuk mungojnë kurrë asgjékund e veçanërisht në Ballkan, bota shqiptare nuk u magjeps aspak nga ky ngashnjim. Vërtetimi më i saktë për këtë ishte re-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

fuzimi që ajo i bëri në përgjithësi fashizmit e doktrinës së tij raciste.

Një nga bazat e ripërtëritjes së armiqësisë midis shqiptarëve e serbëve, pas krijimit të Jugosllavisë dhe mbetjes së gati gjysmës së kombit shqiptar nën sundimin serb, ishte pikërisht ora e revanshit që u erdhi serbëve për t'u hakmarrë ndaj shqiptarëve. Duke fyter krenarinë e tyre (çka ishte gjëja më e lehtë në botë), të mbrojtur pas policisë dhe ushtrisë, serbët iu sulën shqiptarëve më shumë mllef. Në fushatën e tyre kishte një nëntekst të hidhur, nga ata, që duke mos u shfatur asnjëherë `qartë, janë kryesorët për të ushqyer një psikozë shoviniste. Nënteksti ishte ky: ju shqiptarët, që jeni mburrur aq shumë për virtytet tuaja, për besën, kodin, për origjinën ilire, për postet e larta, për superioritetin e racës etj., etj., tanë jeni në dorën tonë dhe ne mund të bëjmë ç'të duam me ju, sepse ne jemi sllavë dhe jemi zot në vendin tonë që quhet Jugosllavi e jeni të huaj në të.

Shqiptarët në këtë rast ishin në rolin e atij që me duar të lidhura duhet të durojë fyerjet më meskine. Për të ndryshuar një gjendje të tillë, që për ta ishte baras me fundin e botës, ata mund të bënin çdo gjë.

Për t'u kthyer te trimëria,, së cilës në Shqipëri i ishte ngritur një kult i vërtetë, duhet thënë dhe kjo ishte vënë re herë pas here nga mendje më të shquara, se në kronikën mjaft të pasur të gjatë të gjesteve trimërore të shqiptarëve, mbe

tej përherë një faqe e zbehtë: ajo e trimërisë shqipërore. Shteti, me sa dukej, ndonëse tani nuk ishte më Perandoria e mynxyrshme Osmane, por shteti shqiptar, mbetej përherë një planet i largët e tepër i huaj për shqiptarin. Madje mund të thuhet pa frikë se pikërisht shteti shqiptar ngjante edhe më tepër i tillë. Malësori shqiptar që s'e kishte për gjë të shkatërronte jetën e tjetrit dhen veten për një fyerje ose një thyerje rregullash kanunore, mbetej si i mpirë «si i shituar nga zana» përpara hijes së nëpunësit civil.

Cilat ishin arsyet e një ngurosjeje të tillë para shtetit të vet? Që këtu nuk kishte kurrfarë vëtflijimi patriotik për arsyet e një shprese që punët do të rregulloheshin, kjo dukej qartas. Shteti shqiptar ngjante hëpërhë i pakërcënueshëm nga askush. Nga ana tjeter, zhgënjimi për të ishte aq i plotë se do të akullonte çdo zjarrmi romantike.

Arsyet e apatisë së shqiptarëve ndaj shtetit të vet, rrjedhimisht, e zbehjes së trimërisë së tyre kur që fjala për raportet me të, duhen kërkuar më thellë. Që një nga shkaqet ishte se ky lloj shteti (shteti i vet), ishte ende një dimension i ri për shqiptarët dhe psikikës tradicionale i duhej njëfarë kohe të përpunonte mekanizmin e saj të kundërshtimit ndaj tij, domethënë trimërinë civile, kjo kuptohej lehtë. Në pamje të parë kjo lloj trimërie civile mund të dukej banale, dhe vërtet në krahësim me përlleshjet te gryka e malit që kallon gjak ose me bëmat zakonore do të dukeshin

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

fare të zbehta e pa kripë acarimet në një mbledhje për ngritjen e çmimeve, demonstratat kundër taksave, grevat dhe fushatat e zgjedhjeve. Aq më tepër që për pjesëmarrjen në këto të fundit jo vetëm që s'kishte asnjë shpresë të përjetësoheshe në ndonjë baladë epike, por mund të bëheshe edhe qesharak në qoftë se nuk dije mjaft truke.

E gjithë kjo kishte të bënte në radhë të parë me shtresat e gjera, kurse elita e shqiptarëve, ajo që kishte marrë pjesë në pushtetin perandorak, i dinte të gjitha labirintet e prapaskenat e tij, ash tu siç i njihët madje nganjëherë më tepër se ç'duhej intrigat e politikës moderne. Por ishte pikërisht një pjesë e kësaj elite që hyri në lojën politike në Shqipëri, duke e ndarë kështu edhe më shumë "hendekun midis shqiptarëve naivë e administratës shtetërore.

Arsye tjetër e hutimit të shqiptarëve ndaj makinës shtetërore, kësaj meduze të re, me të cilën ato do të donin të mos kishin fare punë, duhet kërkuar në psikikën kombëtare, mbi të cilën zakonor ushtronte një trysni të vazhduese.

Shqiptari, qysh në fëmini e gjer në plegërinë thellë, qe mësuar të jetonte me rregulla e kode. Pa e tepruar aspak, në analogji me termin qytet-shtet, në Shqipëri mund të përdorej shprehja shtëpi-shtet. Dhe vërtet ishte vështirë të përfytyrohej gjékund tjetër një shtëpi brenda së cilës jo vetëm ngjarjet e shënuara, por jeta e përditshme të funksiononte në bazë të një zinxhiri rregullash

të detyrueshme për këdo. Kodi përcaktonte gjithçka e me të njëjtin rigorozitet, që nga formulat e përshëndetjes, gjer te sjellja në ngjarjet tragjike. Brenda shtëpisë kryetari i familjes jepte dënimë krejt të ngashme me ato të një kryetari gjyqi. Heqja e të drejtës së fjalës për dy javë. Heqja e armës për një muaj. Burgim për një javë, dy ose katër javë. (Shumë kulla malësore e kishin burgun brenda dhe shprehjet «ra në burg», «ndodhet në burg» ose «doli nga burgu», që shqiptarët i dëgjonin të dielën në sheshin e katundit, tingëllonin aq natyrshëm për burgun e shtëpisë sa ç'ngjanin të pazakonta për burgun e shtetit).

Marrëdhëniet e shtëpisë me shtëpitë e tjera në katund kishin të njëjtin stil shtetëror. Delegacion për pajtim në rast armiqësie. Marrëveshje për armëpushim 15-ditor ose 30-ditor. Dënim nga këshilli i pleqve të katundit për shtëpinë që thyen marrëveshjen etj., etj.

Kështu shqiptari, qysh në vegjeli, mësohej me një nderim të verbër ndaj rregullave e kodeve, dhe meqenëse një pjesë e tyre ishin absurd, rrjedhimisht, ai mësohej t'u bindej ligjeve absurdë. Por nga kjo bindje zakonore te bindja ndaj makinës së shtetit, në rastin kur shteti s'qe i huaj, nuk kishte veçse një hap (a s'të kujtonte nenit 620. për të cituar vetëm njërin nga 1 263 nenet e kodit: «Po të hyni dikush në shtëpi, gjak me të pas do t'i thuash «mirë se erdhe!», me mbërritjen e delegacionit të shtetit armik, dhe a nuk ndodh që

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

në të dyja rastet arsyeva normale njerëzore të su-ndohet nga «raison d'état»?)

Pikërisht këtë nderim ndaj kodit, shteti shqiptar u përpoq ta konvertonte në nderim ndaj tij, dhe kjo ishte arsy që propaganda i mëshonte shumë në atë kohë faktit që mbretëria shqiptare ishte një mbretëri dokesh e që vetë monarku ishte një malësor nga zona e veriut, kështjella e kanunit shekullor.

Ishte e qartë se regjimi i kishte të gjitha arsyet për të përkrahur dhe asnjë arsy që për ta fre-nuar glorifikimin e njeriut tradicional shqiptar me tërë vulat e tij: rregullat, virtytet dhe respek-tin ndaj kodit (lexo: nënshtrimin ndaj shtetit.)

Se ç'tjetërsim kishte pësuar kështu ky njeri në kushtet e jetës bashkëkohore dhe ç'pasoja fa-tale mund të kishte vazhdimi i glorifikimit të ka-nunit, për këtë nuk fliste askush.

Migjeni ishte i pari në letërsinë shqipe që e përshkroi këtë gjendje të dhimbshme të gjérave. Në prozën e tij te famshme «Legjenda e misrit», që ishte një dush i ftohtë kundër euforisë himni-zuese të tradicionalistëve, ai dha një nga tablotë në të pikëllueshme të kohës.

«Nëpër luginat e maleve përshkohet malëso-ri, vetëm me një këmishë e brekë legjendare mbi shtat, për me arrijtë në qendrën e nënprefektu-rès, me marrë misër. Krahnori i tij asht një copë graniti që u shkëput nga mali dhe u vendos mbi dy këmbë të drejta e të forta si landë e pyllit. Dhe lëviz copa e malit pa bëzajtë. E përpara depos së

misrit bjerr cilësinë karakteristike të veten dhe bahet frigacak. Bahet servil, frigacak, pse, — mendoi ai — n'njashtu e don ligji, nëpunësi përndryshe s'ka misër. «Si urdhnon, zotni» përshëndet sa e sa herë në mnyrë qesharake, me të marrun zani, me gjeste majmuni — vetëm e vetëm mos me zgjue mninë e engjujve që ndajnë misër».

Një shuplakë e tillë çmitizuese nuk ishte parrë ndonjëherë në letrat shqipe. Ja, pra, ç'ka u kishte punuar shqiptarëve shteti i vet, thoshte Migjeni. Ata shqiptarë që s'e kishin patur për gjë të përllesheshin me fatalitetin, (sepse një pjesë e kudit të tyre zakonor kishte vulën e tij), tani, në kushtet e jetës civile tjetësoheshin sa s'njiheshin më.

E gjithë kjo lidhej drejtpërdrejt me konceptin për lirinë shoqërore. Për shekuj me radhë, gjersa luftohej për lirinë kombëtare, koncepti i lirisë lidhej kryesisht me pavarësinë, flamurin e ndaluar, administratën e huaj që të merr taksat, ushtrinë e huaj që në rast turbullirash të shkel, të ndëshkon, të përdhnon gratë e zakonet. Merrej me mend që në këto kushte, liria shoqërore ishte një gjë disi e paqartë e një plani të dytë për shqiptarin. I gjetur, me sa duket, në befasit përballë shtetit të vet, truri i tij e kishte të vështirë të shkëputej nga koncepti shekullor i lirisë (gjithë librat e shkollës, shtypi, gazetat, revistat, poemat, këngët, a nuk ishin ende të mbushura me të?), kështu që gati-gati ai nuk e dinte se lirinë, atë liri që ai ia ka kërkuar me forcë të huajve, duhet me po atë

forcë, në mos më tepër, t'ia kërkonte edhe shtetit të vet mbretëror.

Në këtë periudhë kalimtare, kur njeriu shqiptar, pas një ndërprerje pesëshekullore, shndërroj përsëri në shtetas, psikika e tij duhej të ishte në një trazim të vazhdueshëm. Mjafton të vërehet kjo në njérën nga dhjetëra shfaqjet e jetës civile, atë të atentatit politik, një dukuri që duhej të ishte familjare në atë epokë të turbullt. Evoluimi i vrasjes individuale, aq e shpeshtë te shqiptarët për shkak të dokeve, drejt atentatit politik, ende tepër i rrallë, ishte një proces që dëshmonte fare mirë se nëpër c'rrugë të ndërlikuara kalonte formimi i psikikës së shtetasit shqiptar. Vrasja përmotive politike, aq e pakuptueshme më parë për psikikën e njeriut kanunor, i cili pranonte vetëm vrasjen e detyruar nga kodi, nisi të merrete tiparet e veta me shumë vështirësi. Ajo ishte shpeshherë një riprojektim i vrasjes kanunore, një gërshetim me të parën, ose një karikaturë e saj. Shembull për këtë ishte atentati që iu bë tiranit Zog nga njëfarë B. Valteri në shkallët e parlamentit shqiptar më 1924 (poeti Fan Noli ndodhej aty, deputet dhe kryetar i opozitës, dhe plumbat i vërvshëlyen pranë hundës, sic dëshmon ai vetë). Sikur atentatori të kishte pasur vërtet kryesishët motive politike, siç u trumpetua me bujë nga shtypi i kohës, ai do ta kishte vrarë me siguri tiranin, mirëpo më tepër se atentator politik ai kishte qenë ende malësor kanunor, dhe këtë e tregon fakti që në çastin kur kishte dalë nga pusia dhe i kishte vënë revolen në

qafë diktatorit, nuk e kishte qëlluar dot pa i thënë formulën e detyruar nga kodi: «Jepi të fala X-it» d.m.th. viktimës së dikurshme që bëhet shkas për vrasjen e re. B. Valteri, pra, duhet t'i thoshte Zogut: «Falju me shëndet tim ungji», ngaqë, me sa dukej, hakmarrja personale për ungjin e vet, dhe jo fati i popullit shqiptar, kishte qenë motivi themelor i aksionit të tij. Ai kishte hapur gojën t'ia thoshte formulën, por meqenëse i mbahej goja, koha për shqiptimin e saj kishte qenë pakëz më e gjatë se ç'duhej, ç'ka i kishte dhënë mundësi diktatorit të ngrejë krahët për t'u mbrojtur, duke i marrë kështu plumbat jo në kokë por në shpatulla e në duar.

Kur afërsisht në të njëjtën periudhë një student shqiptar, një atentator i vërtetë politik, erdhë enkas në Paris për të kryer m'u në mes të ditës në rrugën «Castalione», një nga atentatet më të bujshme politike të kohës, duke vrarë pa kurrfarë shtyse personale feudalin më të zi shqiptar, Esad Pashën, Shqipëria e tërë u pérndez nga entuziazmi gjë që tregonte se shqiptarët e dëshironin vërtet ndarjen me të kaluarën, në të gjitha format, pavarësisht se nuk e kishin të lehtë ta bënin këtë.

Nuk e kishin lehtë sepse, edhe kur nenet e kanunit perëndonin njëri pas tjetrit bashkë me poezinë epike, muzgu i së cilës kishte rënë, ndërkakq, në vitet 30, vazhdonin të jetonin gjestet, kujtimi i tyre, që herë-herë përsëriteshin si pamjet në një èndërr. Gjatë Luftës së Dytë Botërore në shumë gjeste të partizanëve, si te amanitet në

Castin para vdekjes, në hedhjen sipër tankut, në vetemërtimin e tij, ose të gjithë ushtrisë pushtuese «kuçedër» etj., përvijoheshin konture të eposit. Ato vazhduan të përvijohen edhe shumë kohë më vonë, madje në kushte paqësore, si në grevën e minatorëve shqiptarë në Kosovë të Jugosllavisë, grevë që tronditi botën në shkurt të vitit 1989, dhe ku minatorët ringjallën gjestin e heronjve epikë, të cilët kur zemëroheshin mbi tokë, zbrisnin në zgafellat. Nga ana e tyre, minatorët serbë, për të kundërshtuar grevën e shqiptarëve, zbritën gjithashtu në zgafella, si për të përsëritur dyluftimet e dikurshme shqiptaro-sllave, por ketë herë jo më te «lugjet e zeza», por nëpër gropat mierash. Por këtu, siç u vërejt me të drejtë prej shtypit, imitimi i gjestit prej serbëve (çka u lidh me tezën e imitimit të eposit), ia hoqi atij vëveti peshën tragjike.

Kur të gjitha këto arrijnë të dërgojnë valët e tyre ende sot gjer në fund të shekullit XX, merrët me mend se sa të pranishme ishin në vitet 30. Këto maska, kode tëngrira, kulte e idole që reaksiuni shqiptar, duke i himnizuar, mendonte t'i perdorte si formalinë për të mbajtur në gjendje të paprishur një shoqëri që koha po e shpërbënte pa mëshirë, Migjeni i përshkroi në «Novelat e qytetit të veriut».

Aq i guximshëm ishte në autopsinë e tij, saqë nuk u drojt të kapet me gjëra të shenjta e delikate siç që kulti i nderit, me të cilin gjithashtu po abuzohej gjerësisht. Ky kult ishte ndër më komo-

dët për ta përdorur kundër emancipimit të shoqërisë, për të përligjur ngrirjen si prej dylli të saj. Migjeni, duke u rrezikuar të damkosej me famen e keqe te shkrimtarit imoral, një damkë tē për e rendë, ne mos më e renda për shkrimtarin shqiptar, e zbërtheu pa mëshirë e pa kompromise tē kult duke treguar se ashtu si gjithë kanuni shqiptar, kodi i nderit ishte një dukuri e dyzuar më pjesën e saj tē ndritshme, por edhe tē errët. Në emër tē tij ishin kryer veprime nga më fisniket, por po në emër tē tij ishin kryer krime ngjetëse. Dhe si tē mos mjaftonte kjo, pikërisht pas shpinës së tij, ishin luajtur komedi nga më hipokritet.

Sipas mendësisë që ushqente këtë kult (në tē ishte vështirë tē dalloje fanatizmin vulgar nga një utopi popullore, ngushëlluese, ndoshta, si gjithë utopitë), burrat, e sidomos gratë shqiptare ishin vetveti tē imunizuara nga veset morale. Gjithmonë sipas kësaj mendësie raciste, gratë e vendevë tē tjera, italianet, francezet, sllavet, mundet që tē shtyra nga rrëthana tē degjeronin (sic e pohonin, hm, vetë shkrimtarët e këtyre kombeve), por shqiptarkat kurrë! Arsyet? Kishte vetëm një arsy: Virtytet e racës, përparrë cilave rrëthanat historike, ligjet e zhvillimit shoqëror etj., etj. thërrmoheshin si përparrë një shkëmbi magjik.

Në poemat dhe dramat e shkrimtarëve tradicionalistë vajzat dhe gratë shqiptare ishin «zana» tē vërteta, modele tē virtytit tē kulluar. Me këtë tē fundit kuptohej në radhë tē parë refuzimi

prej tyre i dashurisë dhe i çdo shenje tjetër emancipimi.

Migjeni në novelat e tij, duke qeshur me sarkazëm, po më shumë me dhëmbje, i çorri maskën këtij mashtrimi. Ai e dinte se me këtë akt do të ndillte tèrbimin konservator, i cili në këtë pikë, më lehtë se në çdo tjetër, do të mund ta shfaroste. Ai e dinte, gjithashtu, se bashkë me maskën do të prishte një èndërr, një iluzion naiv tepër të pérhapur në Shqipëri te njerëzit e thjeshtë. Do të plagoseshin zemrat e tyre, sidomos zemrat e nxenësve shqiptarë që, dhe pa këtë, s'ishin të gëzuara. Me siguri, për hir të këtyre të fundit do të ketë hezituar, (në prozën e tij të shkurtër «Zeneli» na rrëfen për një hezitim të ngjashëm), por së fundi ndjenja e përgjegjësisë së shkrimtarit ka fituar mbi mëdyshjen. Dhe ka vendosur ta shpallë ate për shkak të së cilës e dinte se mund të kishte vëç humbje: shqiptarkat ishin si të gjithë të tjerat. Ato i nënshtroheshin të njëjtave ligje të zhvillimit. Në rrethana të caktuara ato, gjithashtu, mund të zvetënoheshin, gjersa të shtyra nga nevoja, të bëheshin edhe prostituta. Madje kishte syresh që ndërkaq ishin bërë të tilla. Dhe jo diku në bulavardet e Evropës, por mu në hundën e të gjithëve, në Shkodër, «kështjellën mijëvjeçare të namuzit».

Gati gjysma e «Novelave të qytetit të veriut» kanë për subjekt prostitucionin. Kështu Migjeni, duke e strukturuar veprën e tij si një univers që shkonte drejt plotësimit, pasi ka treguar se ç'u ka punuar burrave shqiptarë ky shtet e kjo

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

shoqëri (për malësorët që bëheshin servilë te gendra e nënprefekturës, zemrat e nxënësve janë bengosur jo më pak), tani tregon se ç'mund t'u punonte grave.

Te novela «Studenti në shtëpi» Migjeni shkon edhe më larg. Në të tregohet se një pjesë e shoqërisë, madje ajo që ulërin më shumë dhe i bie gjoskit më fort për ndër e namuz, nuk ka as ndër as virtyt, dhe britmat e mallkimet e saj s'janë veçse një alibi që mbulojnë imoralitetin. Heroi i novelës, një student shqiptar që kthehet pas mbarimit të studimeve nga Evropa, pakëz Hamlet, pakëz Rastinjak, i lëshon këtë sfidë shoqërisë shqiptare: «Shoqëri, po deshe të mos lozin në kurrizin tand, ndro format. Hiqi bragashet».

Por bragashat, maskat dhe idolet ishin kudo. Në prozën e shkurtër «Idhujt pa krena» Migjeni përfytyron atë tufan të tmerrshëm, që do të shembë idolet dhe idolatrini. «E ata që lindin në kohën e idhujve pa krena s'dinë kah t'ia mbajnë. Duan të adhurojnë, po ç'ka të adhurojnë? Idhujt pa krena?... Duan të besojnë, po çka të besojnë? Idhujt pa krena?... Kush mund t'adhurojë të shumtue min? Kush mund të besojë në një zot pa krye? Çdo gja që s'ka krye asht kufomë e kufoma s'e ka vendin në mes të gjallve. Kufoma duhet varrosë. Përndryshe e përlyemja me të ka për të qenë katastrofale. E katastrofa asht katastrofë. Nuk kur sen! Zhduk kombe!»

Migjeni ka urrejtje dhe neveri të veçantë për idolatrini. Dhe kjo është e kuptueshme. Për një

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

vend evropian, në çdo formë që të shifaqej, idola-tria ishte një turp. E aq më tepër ishte turp adhurimi i zyrtarëve që mbreti Zog e nxiste me të gjitha mjetet për të arritur te kulti i tij. Ky ishte kulti i monarkut të parë shqiptar, një endërr tjetër e keqe e mbetur prej makthit shumëshkullor otoman. Sepse ndërsa për lajkatarët ai ishte mbreti i parë i shqiptarëve (gjë për të cilën sipas tyre ata duhej veçanërisht të mallengjeheshin), për Nolin ai s'ishte veçse një hije e sulltanit turk.

*Se ç'u rahatos mileti,
Se sultananin prapë e gjeti,
Se, që kur e humbi, s'fjeti.*

Kurse për Migjenin ai s'ishte veçse një «idhull i rrëzuar» nga ata qindra idhuj pa krye që duheshin shembur përgjithmonë.

Migjeni e di se sa më i madh të jetë kulti i sunduesit në një vend, aq më e vogël është liria e vendit. Një gjeometri e pamëshirshme e bën të qartë se nuk ka vend për të dyja. Por Migjeni e di, gjithashtu, se për një vend të vogël barra e kultit të personit është dyfish e rëndë e tragjike.

Krijimi i kultit ndihmohet nga hapësirat e mëdha, nga mosshfaqja, enigma, mosnjohja. Por në vendet e vogla, ku hapësirat janë të ngushta, ku pothuajse s'ka të fshehta ngaqë gjithkush njeh gjithkënd, në këto vende, pra, mungon ajo amnezi e domosdoshme që krijon misterin, dhe të parët që do të qeshin me sunduesin e porsashpallur do të

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

jenë njerëzit e lagjes, shokët e shkollës e të kafenesë, që ia njohin aq mirë edhe cilësitë, edhe vëset. Mirëpo qyteti i lindjes së tiranit s'është larg qytetit fqinjë dhe ky i fundit s'është veç dy hapë larg kryeqytetit, kështu që mungon hapësira që do të mjegullonte faktet e do të shuanë të qeshurën ironike.

Kjo bën që tirani i vendit të vogël të tërbohet. Me terror ai kërkon të krijojë mjegullën, enigmën, amnezinë, këto pudra të domosdoshme për kultin. Dhe meqenëse nuk i krijon dot, atëherë mpreh hanxharin.

Ja, i pamëshirshmi Fan Nol, e ftoh keqas zjarrminë e monarkistëve duke u kujtar të gjithëve se mbreti vërtet është nga një zonë epike, por kjo është njëkohësisht krahina e shquar në Shqipëri për pastiqierë endacakë. Ai shkruan:

*Ç'është ky sheqer-kësмет:
Hallvaxhinë e pamë mbret.*

Duke luajtur shkëlqyeshëm me shprehjen orientale «sheqer-kësмет» (shans i ëmbël, i bukur), poeti u kujton shqiptarëve se njeriu që është shpallur mbret august, mund të ishte fare mirë një ëmbëltor ambulant nga ata që vërtiten trugicave ose pranë oborreve të shkollave gjatë puhimit.

Mbreti Zog tregohet i duruar. Është herët të mprehë hanxharin që më gjak e tmerr t'i detyrojë bashkëkohësit të harrojnë prejardhjen e tij aspak **auguste.**

Migjeni nuk e ka zënë në goje asnjëherë monarkun në veprën e tij. As Poradeci. Noli e ka përmendur vetëm pér keq. Ndërkaq marrëdhëniet e të treve me tiranin kanë qenë tejet të ndryshme.

Fan Noli ka qenë armiku i tij i shpallur në gjithçka, fantazma e tij e zezë, helmi i tij. Në përleshjen me të kishte fituar, e kishte përbysur, e kishte dëbuar dhe kjo gjë me siguri i jepite herë-herë qetësi, e shëronte prej ankthit. Por sado të ngushtë ta kishte patur vizionin e gjérave, turbull duhet ta ketë ndier tmerrin që i shkakton përherë fitimtarit injorant mendja e ndritur e të mundurit. E kishte dënuar me vdekje në mungesë ose më saktë, të dy e kishin dënuar me vdekje njëri-tjetrin, njëri me një juri gjyqësore, me nene të kodit penal, me plumb e konop, tjetri me rrjetë e rëndë të vjershavë. Dihet se në një dyluftim të tillë të tiranit me poetin është gjithmonë porti ai që fiton, ndonëse përkohësisht mund të duket i humbur. Noli e fitoi dyluftimin para kohe, në gjallje të të dyve (Zogu e humbi froni më 1939), pa pritur kohën eterne, atë që është përherë e poeteve.

Disa herë qe përpjekur ta afronte Lasgush Poradecin, këtë nosit sqimatar të poezisë shqipe, por nositi qëndronte larg. Merrej me qiejt e tij, me dashuritë, me ndërrimin e stinëve, yjet, vdekjen, pavdekësinë, duke u treguar shqiptarëve se c'mrekullira mund të bëhen në letërsi me gjuhën shqipe. Universi poetik që ai kishte krijuar s'kishte të bënte fare me mbretërinë e zymtë arkaike,

përbuzshëm ndahej prej saj, si për të pritur një kohë më të butë, çka zgjonte admirim te disa e një qortim te të tjerët. Mbreti Zog, si një pjesë e tiranëve, e kishte vështirë të kuptonte rrezikun e bukurisë. Së paku ky s'më nget, do të ketë thënë shumë herë me vete. Ndaj as unë s'kam pse ta ngas.

Mbreti me siguri nuk e ka njojur Migjenin. Muslet as e ka lexuar, veç në qoftë se ka parë raporim e censurës për ndalimin e tij. Por edhe si kur ta kishte njojur djaloshin e hajthëm nga Shkodra, do t'i dukej më pak i rrezikshëm nga të re, ai që në të vërtetë ishte kundërshtari më total i tij. Ndonëse nuk e kërcënonte drejtpërdrejt me shfronësim si Noli, (qershori i vitit 1924 kur poeti e kishte përbysur tiranin ende e tromakste në gjumë), ndonëse nuk e sfidonte tërthorazi si Poradeci, që e kishte krijuar ndërkaq fronin e tij në mbretërinë e poezisë, Migjeni ishte shkrimitar që e rrezikonte më vdekshëm nga të gjithë. Se pse ai nuk synonte vetëm fronin, institucionet e rrangallat e tjera të regjimit, ai synonte tabanin mbi të cilin mbështetëj ky regjim; mjerimin, injancën, moralin, dogmat, maskat, idolet, gjithçka:

Sikur t'i njihte mirë që të tre, e kryesorja, sikur ta kapte saktë artin e fjalës, monarku do të kuptonte se nga mallkimet apokaliptike të Nolit mund të mos pësonte gjë (a s'kishte plot pesëmbëdhjetë vjet që ai veç e mallkonte?), e aq më pak mund të dëmtohej nga mospërfillja elegante e Poradecit. Kurse nga gërryerja e përgjithshme, e

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

ditpërditshme e Migjenit ai do të mbetej shumë shpejt pa fron, pa mbretëri, pa histori, pa asgjë.

Të tillë shkrimtarë të tipit të ri po vinin, përfatkeqësinë e tij e të mbretërisë së tij, në letërsinë shqipe.

Ata ishin të tre, ndcnëse në mënyra të ndryshme, shkrimtarë të tipit të ri. Ç'prej disa kohësh, letërsia shqipe kishite nevojë për ta: Skleroza që e kërcënonte këtë letërsi ishte një sëmundje e njohur e herëpashershme, që e kishin pësuar e do ta pësonin letërsitë e të gjitha vendeve.

Letrat shqipe prisnin me ngut ardhjen e shkrimtarëve novatorë, ata që do të thyenin rutinën, që do të zgjeronin venat e saj të ngushtuar, që do të shkatërronin kishetë parazitare, që do t'u rikthenin fjalëve lirinë e humbur, së fundi që do të vinin në gjunjë aradhën e medickërve, këtë ushtri të pafundme, të palodhshme që herë -herë ngjante e pamposhtur në monotoninë dhe hirnosjen e saj.

Në ato vite, ashtu si përgjithësisht në të gjitha kohërat e në të gjitha vendet, flitej pak përluftën midis artit të madh e mediokrititetit, kësaj

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

lufte të egër, totale, ku ky i fundit, mediokriteti, ka patur po atë mungesë rrezikimi, që ka shkretëtira përballë lulëzimit. Por edhe kur flitej, ashtu si kudo në botë edhe në Shqipëri, zotëronte ai vizion optimist e romantik që e quante të pashmangshme fitoren e artit të madh mbi artin mediokër. Ky vizion ngushëllues, që vazhdon të zotërojë ende sot, është, për fat të keq, fare i pasaktë. Ai është i pasaktë sepse ne dimë fitoret e artit të madh por nuk kemi asnjë dijeni për humbjet e tij. Dhe e kundërtë: nga arritjet e artit të madh ne i marrim me mend humbjet e mediokrititetit, por ndërkaq nuk dimë asgjë për fitoret e tij, që ndonëse anונית, pa emër, pa histori, duhet të ketë qenë gjithashtu kolosale.

Pra, në nuk dimë asgjë nga ajo që mund të ketë ndodhur në zonën e hijes, në kaosin e zyrtë primordial, ku ndeshja është zhvilluar heshturazi, pa dëshmitarë e në gjysmëterr.

Por ndërsa ne nuk e dimë, krijuesit e mëdhenj e kanë ndier pa përjashtim, në shkallë të ndryshme, kërcënimin e kësaj *ahistorie*, vrimë e zezë thithëse që i ndjek gjatë gjithë jetës.

Migjeni, ndonëse tepër i ri, duhet të ketë ndier se c'rrugë të rrezikshme po i hynte. Nga dy novatorët e tjerë të mëdhenj, Noli e Poradeci, vetëm ky i fundit batohej e adhurohej, sepse tjetri qe i ndaluar. Nuk mund të parashikohej se çdo t'i ndodhte Migjenit po të arrinte të botonte veprën e tij. Kishte mundësi që ndërsa me «Vargjet e lira» t'i lante hesapet shteti; (gjë që edhe në një-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

farë mase u bë), «Novelat e qytetit të veriut» mund t'u lihej si pre mediokërve, të cilët, më mirë se shteti ndoshta, më pamëshirshëm e më pa shpresë, do ta varrojnë.

Migjeni ishte novator dhe si i tillë do të kishte fatin e një novatori.

Të tre ata ishin novatorë sipas një mënyre të veten, sepse secili sipas një mënyre të veten vendosi një raport midis tij dhe kohës, midis artit të tij dhe artit shqiptar.

Noli solli në letrat shqipe poezinë filozofiko-politike, në kuptimin e madh e të mirëfilltë të fjalës. Poet e njëkohësisht personazh legjendar i saj, ai krijoj një poezi politike të madhërishme si rrallëkush në letrat evropiane. Kryeministri më i kultuuruar evropian, në vendin më të prapambeetur, ai e këndoi fatin e tij të zymtë pa kurrfarë sentimentalizmi e snobizmi, me ncta epike që ngjanin sikur vinin drejt e nga kohërat antike greko-iliriane. Ai nuk shkruan kujtime si shumica e burrave të rrëzuar të shtetit, nuk përligj veprimet e tij, nuk bën moral. Ai ka disa fantazma e disa dilema që e trazojnë ende. Mos qe treguar tepër i butë me të keqen? Mos duhej që Krishti të kishte në dorë edhe kamzhikun? Apo ndoshta ishte më mirë kështu, largimi nga pushteti pa lyer duart me gjak?

Ndryshe nga Noli, Lasgush Poradeci e realizonte largimin e tij nga trädita, shtampat dhe bragashat shqiptare me tërheqjen e tij imperiale në zonat e paarritshme për të tjerët. Poezia e tij

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

ka një frysme emancipimi të paparë. Në botën ballkanase e veçanërisht atë shqiptare, të vulcsur nga kulti i mashkullit, nga «lisi i gjakut», nga arma, triumfi dhe zija për meshkujt, Poradeci ngre një kult të ri, atë të femrës e të dashurisë. «Dashuri, heu mall i ri!» shpall ai në formë manifesti. Asnjëherë në Shqipëri e ndoshta në krejt letërsinë moderne të Gadishullit Ballkanik femra dhe dashuria nuk qenë kënduar me aq finesë e përkushtim. Një përndritje suverene, një luks i lodhur, e përshkon tejembanë këtë poezi, dhe kjo nuk është pak, kjo zbutje e ky ton i ri në vendin ku shpesh për të përshëndetur një grua përdorej formula: «si je burrneshë?»

Ndryshe nga dy të parët. Migjeni e ndan vreten e tij nga epoka, me anë të rrugës më të vësh-tirë: duke qenë i ngjitur me të, Ai, siç e shpall vetë, ka qejf të zhgërryhet në baltërat e kohës, të përshkojë tejembanë ferrin e saj. Është kurthi më i madh për një shkrimitar kur ekranit tepër i afërt i ngjarjeve, pasioni dhe anësia mund t'ia sigurcjmë militantizmin, por t'ia zbehin vizionin e madh artistik. Madhëشتia e Migjenit qëndron pikërisht në atë që edhe duke qenë në terr e në baltë, nuk e humbet asnjëherë atë vizion. As grija e jetës së përditshme, as konkretësia e ngjarjeve e, së fundi, as pasioni i tij, nuk e zhveshin veprën e tij nga ai thesar i paçmuar që është universalizmi.

Të tre shkrimitarët e mëdhenj të epokës mund t'i përfytyrojmë (dhe kemi arsyë për këtë),

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

si të vendosur në tri zona: në zonën qiellore, Poradecin, në një zonë mërgimi, njëfarë purgatori, Nolin, dhe në ferrin e ditëve të zakonshme, Migjenin.

Asnjë referim nuk kanë këta tre shkrimitarë për njëri-tjetrin, thua se edhe fizikisht jetojnë vërtet në tre lartësi. Që s'janë takuar kurrë, ajo dihet, por çka është vërtet e habitshme është krijimi i përshtypjes se nuk e kanë lëxuar kurrë njëri-tjetrin.

Në atë kohë në shtypin letrar shqiptar shpeshherë shfaqej shpresa se ndoshta në letërsinë shqipe do të vinte më në fund një gjeni, një Dante, një Shekspir ose një Gëte. Ishte një ëndërr që ndonëse pakëz e guximshme, ngjante gjithsesi e mundshme për kombin ku gjithçka mund të ngjante e tillë në mëngjesin e natës pesëqind-vjeçare.

Kur vitet kaluan dhe mund të gjykohej gjak-
ftohtësish edhe për këtë ëndërr, u bë e qartë
se asnjë prej tre shkrimitarëve të mëdhenj shqip-
tarë të fillimit të shekullit XX nuk e kishte plot-
tërinë e gjeniut. E, megjithatë, te secili prej tyre,
ku më pak e ku më shumë, mund të gjeje rrëzë-
llima gjeniale. Ngjyrimet danteske te Migjeni,
furi në shekspiriane te Noli dhe serenitetin gëtian
te Poradeci. Kështu që, ndonëse vec e vec s'mund
të quheshin gjeni, të tre së bashku, qellori Pora-
dec, mitiku Nol dhe infernali Migjen, e përbënin
një gjeni të plotë.

Ata e ndanë tē tre kurorën me gjemba tē shkrimtarit tē madh, thua se e ndien që, në një vend si Shqipëria, ajo kurorë ishte tejet e rrezikshme po t'i mbetej njërit.

Ashtu si mbretëria e tij, vetë Zogu ishte një tiran difensiv, ngaqë, përveç arsyeve tē tjerë, ishte ende i ri, pra ende pa pleqërinë e tij, pjesën më mortore tē një tirani. Por pleqëria nxinte përpara dhe ata duhej tē ishin tē përgatitur përtë si për një dëmër tē vështirë. Sepse, sipas një shkallëzimi tē njobur, bashkë me vitet do tē shtohej zymtia, egërsimi dhe krimet. Dhe dihej se midis pasioneve tē një tirani tē plakur, xhelozia për «shkrimtarin e madh» ishte një ndër ato që bëheshin përherë e më zotëruesse.

Nga tē tre poetët, raportet e monarkut me Nolin ishin më tē qartat. E dinin tē gjithë që pas çdo përpjekjeje për ta blerë, orvatej ta vriste, e

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

pas çdo dështimi të vrasjes, orvatej prapë ta blinte, e kështu vazhdonte ky makth për të dy (në rastin e Faik Konicës e kishte arritur një zgjidhje kompromisi). Pas takimit e bisedës së tyre të vitit 1929, të fshehtën e së cilës e morën me vete të dy të në varr (ç'nuک do të jepja të merrja vesh se ç'folën mbreti me ministrin e tij, shkruante Noli), Faik Konica, ky grindës i pashoq, ai i cili më 1913, fill pas themelimit të shtetit të shumëpritur shqiptar, kishte vrapuar në Shqipëri, jc për të bërë gjë tjetër, por për t'u grindur për vdekje qysh në takimin e parë me kryeministrin dhe themeluesin e shtetit, e për të vazhduar pastaj serinë e grindjeve hōmerike me të gjithë kryeministrat e presidentët, duke përfshirë edhe mbretin, e duke përfshirë madje edhe mikun e tij Fan Nolin, me të cilin pas çdo pajtimi, shpejtonte të armiqësohej përsëri, Faik Konica, pra, dukej se më në fund ishte qetësuar. Kishte gjetur një formulë të re paksa të çuditshme: mbretin ta shajmë brenda përbrenda shtetit, por jashtë ta mbrojmë, i binte lirës në orët e mërzisë në sallonet e ambasadës në Uashington, dhe askush nuk e dinte ç'bluanë në kokë. Ndërkaq, në gjyqin që po bëhej në Vjenë kundër një atentatori tjetër të mbretit Zog, që e kishte qëlluar sovranin duke dalë nga opera, avokatët përdornin si argument mbrojtjeje për atentatorin, artikujt e mëparshëm plot helm e tallje të Konicës kundër sovranit. Por, si njëri si tjetri, bënin sikur nuk e vinin re këtë. Epilogu i këtyre raporteve paradoksale, do të ndodhë në

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

vitin 1942, kur as njëri s'ishte më mbret e as tjetri ambasador, dhe kur mbi arkivolin në të cilin, nën muzikën e Vagnerit, qe shtrirë Konica i vdekur, mbërriti nga Londra një kurorë e papritur, ajo e ish-mbretit (ishte e kuptueshme që për atë kurorë i vdekuri nuk mund të jepte dot shpjegime).

Me Lasgush Poradecin vazhdonin të njëjtat marrëdhënie si midis fantazmash. Secili bënte sikur nuk e shihte tjetrin.

Sa për vjershën programatike «Zog i qiejve», me të cilën Lasgush Poradeci kishte shpallojur sovranitetin e tij në qzell, në kundërshtim ndoshta me Zogun e dhet, d.m.th. mbretin Zog, edhe atë sundimtari kishte bërë sikur nuk e kishte vënë re. Ose ka thënë me vete: le tëundojë në qzell si gjithë të marrët. Mua më mjafton toka.

Por veç kësaj zgjidhjeje të përkohshme, për Poradecin mbetej ndoshta edhe një zgjidhje tjetër, më e vonë, atëherë kur tirania të ndihej më e fortë. Atëherë mund të ishte tamam koha që ai të paguante atë «yllësimin» e tij. Do të gjendej një mënyrë për të zbritur zçgun e qiejve, atë që kish te shkruar:

*Në pat lindur vendi i zotit,
E bëj punën e njeriut.*

do të gjendej, pra, një çark për ta kapur e për ta mbyllur në kafaz.

Kaq shumë notonte në erë kjo ide, saqë kur i

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

famshmi ministër i Kulturës e risulmoi poetin më 1946, me një vjershë të botuar qysh më parë, akuzë e tij në vargje ishte formuluar pikërisht kështu:

*Të blenë me para o zog ligeri,
Të futën në kuvli që të këndosh.*

Ishte një rast i rrallë kur shpalaj si e vërtetë një gjë që s'kishte ndodhur, por që kishte qenë realitet në ndërgjegjen e shumëkujt, ndoshta pikërisht në ndërgjegjen e atyre që, me sa duket, do të bënin këtë gjë, po të kishin qenë në vendin e poetit.

Por kjo nuk ishte e vetmja rrugëzgjidhje. Për të vrarë një poet nuk është asnjëherë vështirë. Një nga mënyrat, ndoshta më e sigurta, mbeteshin prapë bashkëkohësit mediokër, kjo aradhë ndëshkimore e pashoqe, që më mirë se kushdo mund ta mbyste poetin duke e rrethuar me mizerjen gri të ditëve, me shurdhëri e baltë. A nuk e kishte parashikuar vetë poeti këtë në vargun e përzishëm e plot pikëllim: «Vdiq nëpërka pikelore ndaj blatishtë e shkretëtirtë»?

Nga tre të mëdhenjtë, Migjeni ishte ende i pashfaquri. Gjer në fund civil, ai ishte i vetmi që s'kishte raporte plumbi ose helmi me diktatorin, por raporte të reja civile. Migjeni ishte i pari shkrimitar i shquar shqiptar që goditej nga një armë e re, banale në pamje, por e vdekshme si asgjë tjeter: censura.

Për Nolin, Konicën, Poradecin censura ishte

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

{ aq e papërfytyrueshme, sa ç'ishte për kreshnikët e eposit shqiptar vrima që u hapi befas në trup plumbi i armës së zjarrit, në epilogun e eposit. Prej asaj vrime ata u shqyen gazit në fillim, pastaj ndien dhimbjen, u dëshpëruan dhe me sokëllima e braktisën dheun për të zbritur në guva, ngaqë e kuptuan se epoka e tyre kishte marrë fund.

Nuk mund të thuhet saktë se çdo të ndodhë, por pak e shumë i këtij lloji pritej të ishte reagimi i «luanëve të letrave shqipe» ndaj kësaj arme të re tinzare. Do të plasnin me siguri buja e skandale të mëdha, mallkime e sokëllima që dhe pa të s'kishin qenë të pakta.

Migjeni e priti goditjen e censurës me qetësi të plotë. I ndërgjegjshëm për natyrën e artit të tij, ai e kuptozi se ajo armë ishte për të, i shkonte si të thuash atij, ndaj s'kishte arsyen as të habitej, as të vinte kujën. Si ta parandiente këtë, kishte shkruar më parë vargjet:

*Na të birtë e shekullit të ri,
me hovin tonë e të ndezun peshë,
ndër luftra të reja ke me u ndeshë
e për fitore kem' me ra fli.*

Nuk bëri, pra, asnjë përpjekje për të çliruar librin, as deklaratë e protestë. Por nuk bëri, gjithashtu, asnjë modifikim në artin e tij. Përkundrazi, ai erdhi e u zymtua edhe më. Dy vargjet mbyllëse të vjershës «Rezignata», një ndër të fun-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

dit që shkroi, ishin si qëndizma mbi një cohë ceremonie varrimi:

*Kah rrugët janë të shtrueme me ferra e
rreth të cilave shihen
varret të shpëlamë me lotë e të marrët
që zgërdhiken.*

Ndihej menjëherë që Migjeni bëhej gati të mbante pjesën që i takonte nga kurora treshe, kjo regjencë e poezisë, që si cdo regjencë ishte në pritje të një sovrani të letrave shqipe.

Por ky sovran ose ky gjeni i èndërruar nuk kishte vend në një mbretëri tiranike si Shqipëria. Monarku Zog, siç e kishte portretizuar vetë ministri i tij Konica, «urrente të gjithë ata që kishin njëfarë vlere, qoftë kjo kulturë, fis, pronë apo afëtësi të cdo natyre». S'ishte e vështirë të merrej me mend se urrejtja apo zilia auguste do të binte në cdo rast mbi gjeniun e vetmuar.

Dihet se në një regjim tiranik shkrimtari i madh i vetmuar është njëlloj si druri që i kanë vënë shenjën pér t'u prerë. Vetë shkrimtari, ende pa e vënë re shenjën, që të tjerët e kanë pikasur prej kohësh, fillon e vuani nga një ndjenjë faji. Në fillim e turbullt, si ankthi i njeriut që duke qenë në gjumë ndjen të keqen që i përgatitet, ndjenja e fajit sa vete rritet bashkë me famën e tij.

Ka kapërcyer fazë pas faze atë që dukej e pakapërcyeshme. Ka paguar taksën pér të qenë

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

shkrimtar, por minimumin e taksës për të qénë shkrimtar i madh, e aq më tepër shkrimtar i madh i vetëm. Ka ecur midis shtetit diktatorial dhe kollegëve të tij mediokër, si midis Shilës e Hariblës (oh, këta të fundit, kolegët mediokër, që ishin përherë zgjuar, madje edhe atëherë kur shteti mund të dremiste pak). Në orët e pushimit të dhimbjes, e ka ngushëlluar veten me mendimin se nën diktaturë lindnin nganjëherë vepra të mëdha, ashtu siç thuhej se nga trysnitë e kobshme krijoeshin diamantët. Por ngushëllimi s'ka vazhduar gjatë e zakonisht ka përfunduar me shfryrjet: në djall të venin veprat, të vogla a të mëdha qofshin.

Ka mposhtur joshjet e njëpasnjëshme të privilegjeve, posteve, nderimeve, duke mos i refuzuar bujshëm për të mos e acaruar diktaturën, por duke mos i dhënë ndërkaq asaj asgjë si shpërbirim. Ka përballuar kërcënimet e para, disi të mjegullta, por që ngjajnë edhe më të frikshme pikërisht ngaqë janë të mbështjella me paqartësi. Ka përballuar kërcënimet e dyta, më të hapëta e më brutale. Pastaj ka ardhur ajo që pritej, goditja e parë, e hidhur si çdo goditje e parë por që bashkë me zinë i ka sjellë për çudi jetës së tij një shkreti mospërfilljeje e sereniteti shurdh. Por pas kësaj i ka ardhur goditja tjeter, në një kohë e një vend ku s'e priste, që ia ka humbur drejt peshimin krejt. Pastaj i ka ardhur goditja e tretë, që e ka kujtuar fatale, pas së cilës ka pritur rrëzimin.

Kjo është koha e parapëlqyer e diktaturës, për të bërë jo rrëzimin, por joshjen e fundit, atë

më të rrezikshmen, ngaqë i ofrohet shkrimtarit në pushimin midis terrorit, atëherë kur shpirti është i vrarë dhe mendja s'sheh dritë kurrkund. Është ora e trishtë kur brenda tij krenarisë ia zë vendin përdëllesa dhe muzgu ia ndryshon të gjitha përmasat e gjërave. Në qoftë se ai i qëndron edhe kësaj prove të fundit, atëherë kambana ka rënë për të dhe «vdekja është paralajmëruar», veç në këtë rast, thikat nuk i mprehin dy kasapë vrasës, por një shtet i tërë.

Për ironi të fatit, pikërisht në kohën kur ai e ndjen veten në buzë të greminës, shumë njerëz thonë: lum ai, është aq i njohur sa diktatura s'ka ç'i bën. Ká në këtë gjykim edhe zili, edhe qortim. Zili për statusin e tij të veçantë, qortim se me atë status ai mund të bënte diçka më tepër për kombin e vet.

Ai e di atë gjykim ashtu siç e di, ndoshta më mirë se kushdo, se diktatura vërtet s'ka ç'i bën. Me këtë «s'ka ç'i bën», nënkuptohet në radhë të parë burgimi. Kuptohet që derisa burgu përjashtohet, as që mund të bëhet fjalë për dënimin e skajshëm, me vdekje. Mirëpo rrallëkush e mendon që pikërisht përjashtimi i burgut ngajeta e tij, është dhe një nga kyçet e tragjedisë së tij. Ai është zhveshur nga shansi që e kanë mijëra të tjerë. Burgu për të është një luks, një oaz i ëndërruar. Madje dhe njerëzit e diktaturës, në përgjimet e tyre të shumta, kur të jenë ndeshur me fjalën «burg», që ai vetë ose miqtë e tij e kanë shqiptuar, do të kenë qeshur me ironi: ha, ha, burgu,

kujton se jemi aq budallenj sa të na i hedhë. Da-shka edhe burgun, pa le, që t'i shtohet lavdia e mallkuar. Ç'i pangopur!

Ai i di të gjitha këto. Ai e di që e ka humbur shansin e burgut, këtij zakoni të vjetër të mirë, dhe se pikërisht për shkak të lavdisë (të mallkuar, vërtet), nuk ka zgjidhje tjetër veç të rrëzohet menjëherë nën dhe.

Tani s'i mbetet veç të mendojë llojin e vdekjes që i përgatit diktatura: helmin në filxhanin e kafesë, përplasjen e makinës ose thikën e një gjoja të dehuri te shkalla e errët. Nga që është marrë gjithë jetën me shkrime nuk e ndalon dot trurin të mendojë nekrolcjinë, madje dhe stilin plot pikëllim të saj.

Është ora kur, ashtu si shumica e njerëzve në prag të rrëzimit, ai përpinqet edhe një herë të gjejë se ku e ka hedhur hapin e gabuar. Gjatë përsiatjes së trishtë qëllon që e gjen më në fund gabimin fatal: s'duhej ta kishte lënë veten të bëhej shkrimitar i madh vetmitar. Duhej të priste të tjerët, të frenonte talentin e tij, t'ia merrte frymën, ta mbyste po të qe nevoja pa mëshirë, gjersa të mbërrinin të tjerët.

Por të tjerët kanë vonuar dhe e kanë lënë vetëm.

Atëherë ai bën një zbulim të ri akoma më të frikshëm: të tjerëve nuk u kishte munguar ndoshta talenti i madh, por ata s'e kishin lënë të shpërthente, e kishin flijuar, e kishin gjymtuar, e kishin prishur pra vetë atë talent për hir të... mbi jetesës.

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

Ishin treguar, pra, më të zgjuar se ai, ndaj tan i do të rrinin e do të bënин sehir (siç bëjnë sehir nga dritaret e ballkonet, në një shesh të shkretë të Palermos), njeriu që shkon drejt humbjes.

Në çastet para mbarimit, atëherë kur mendja ndodh që fiton një kthjellim të fundit, e kupton se veç nënshtrimit ka patur një shans tjetër shpëtimi, një shans të vetëm: flakjen e kurorës së shkrimtarit të madh. Ndoshët dhe e ka menduar më parë, ndoshët dhe ka shfryrë kundër saj: kurorë e mallkuar!, por vetëm tan i kupton se edhe po të donte, atë kurorë nuk e hiqte dot. Ashtu si në një veprim të ngadalësuar në èndërr, koha përtat hequr atë kurorë nga kokë e përt ta flakur përdhe, duhej të zgjaste së pakut dy-tre vjet.

Sepse nuk mjafton një deklaratë modestie, një shpallje madje e bujshme se ti nuk je shkrimtar i madh, se s'ke qenë kurrë, se ky nuk ishte veçse një keqkuptim, një haluçinacion kolektiv, një intrigë, qëllimkeqe etj., etj. Nuk mjafton, pra, të thuash se edhe në qoftë se ke patur ndonjë shkëndijim gjeniu, ajo që një rastësi dhe i përket krejtësisht së kaluarës, kurse prej kohësh ti e ke humbur gjithçka, je bërë mesatar, madje më tej se mesatar, përtë mos thënë je budalla-llepsur, sklerotizuar, idiotizuar.

Por kjo nuk mjafton. Duhet diçka tejhamletiane, (pra, diçka më e thellë se loja e çmendurisë së Hamletit), përtë bindur diktaturën se jependuar vërtet. Ajo mund të bindet përt këtë jo nga deklaratat, por nga provat. Pra, duhet që

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

jo të sillesh keq, por të shkruash keq, varfër, zbeh-të, përhimshëm, me një fjalë të bësh atë që ke urryer më shumë në jetë: të mediokrizohesh.

Kjo fjalë është e magjishme për diktaturën. Ajo do të pshëretijë e lehtësuar: më në fund e kuptoi ç'duhet të bëjë. Tani le ta lëmë t'i hapë varrin vetes dhe le të bëjmë sehir si do të zhbëhet mu në sytë tanë. Tre-katër vjet dhe kjo punë (ky varr) merr fund.

Ky do të ishte rrethi i fundit i ferrit dantesk për shkrimtarin. Dhe për këtë ai duhet t'i jetë mirënlohës diktaturës.

Mirënlohës ai duhet t'i jetë në të gjitha rastet. Mirënlohës ngaqë botohet, çmohet, thirret në pritjet qeveritare? Pa dyshim, por kjo s'është kryesorja. Ai mund të mos çmohet, të mos thirret në pritje qeveritare, të mos botohet (madje të ndalohet), dhe prapë të jetë mirënlohës.

Pse? Përgjigjja është e qartë: sepse është lë-në gjallë, jeton. Por edhe kjo nuk është absolute. Atij mund të mos i lihet as ky shans, pra mund të vdiset e prapë të jetë mirënlohës. E tani, pse? — mund të pyetet për herë të fundit. Përgjigjja është e thjeshtë: për fëmijët.

Vetëm një mrekulli mund ta shpëtojë shkrimtarin e madh nga ky fatalitet. Në këtë rast, ky shkrimtar, që vjen nga zona e hijes, ky ex, nën e mbinjeri njëkohësisht, nuk pret këshilla nga askush e nuk pranon moral nga askush.

Ai është tepër, tepër i lodhur.

Në dhjetor të vitit 1937 me vaporin që bën-te rrugën Durrës-Bari, Migjeni u nis për t'u ku-ruar e ndoshta pastaj edhe për të studiuar pér letërsi, në Itali. Nga kjo rrugë ai nuk do të kthe-hej më.

Ishte hera e parë që largohej nga Shqipëria nëpërmjet detit, në këtë drejtim. Gjer tani kishte udhëtar jashtë shtetit kryesishët nëpër tokë dhe në trojet që i përkisnin dikur Perandorisë Bizantine. Kurse tani po shtyhej në pjesën romake...

Cdo shqiptari të kultivuar, o është do ta bënte në atë kohë këtë rrugë, do t'i kishte jetër diçka nga historia ose së paku diçka nga perandori, trysninë e të cilave ndur midis tyre, e kishte provuar Ajo trysni. Kishte lënë gjurmë psikikën e saj, ishte trashëguar

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

shekuj, për të mbërritur gjer në kohët moderne.

~~Dy poetët më të mëdhenj të Rilindjes shqiptare, Naim Frashëri e Jeronim de Rada, i kishin ndarë, si të thuash, në poemat e tyre, këto dy rrafshë perandorake. Tek i pari, Frashëri, ndihet toka, ranishtet e pafundme, pluhuri dhe sidomos shkretëtirat e Lindjes, që ai i kishte përshkruar aq mjeshtërisht si për t'u kujtuar shqiptarëve se nga u kishin ardhur fatkeqësitë. Në peizazhin poetik të të dytit zotëronte deti, bluja mesdhetare, lumbardhat dhe kambanat, një botë që shqiptarët desh e kishin humbur.~~

Migjeni po largohej nga vendi i tij nëpërmjet detit Adriatik, një ndër më të bukurit e botës, por që në atë vit, më 1938, që zymtuar si rrallë ndonjë det nga egërsimi fast ist.

Nuk është e rastit që në shënimet e tij përkëtë udhëtim Migjeni e kujton Perandorinë Romake, këtë referim të vazhdueshëm të fashizmit, që përpinqej ta kthente në një fantazmë frymëzuese. Por Migjeni kujton diçka më tepër: si përt'i hedhur një dush idilit të miqësisë që sa vinte rritej midis dy vendeve (dushi i ftohtë bën pjesë përherë në makinën e tij krijuese), ai kujton diçka më tepër se ç'duhet, dhe pikërisht armiqësinë mortore midis romakëve dhe ilirëve, stërgjyshërvë, të shqiptarëve. Është pa dyshim një kujtim krejt i papëlqyeshëm, festëprishës, siç janë zakonisht zilet e alarmit midis një idili.

Është hera e parë që ai largohej nga vendi i tij, jo më si student por si shkrimitar. Dhe vizioni

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

i tij tashmë është fare i ndryshëm nga herët e tjera. Në horizont kanë humbur kambanaret dhe minaret e Shkodrës, më pas prapa ujërave të detit kanë humbur malet e hirta dhe tanë Shqipëria është vetëm në-trurin e tij. Por edhe atje ajo është në formë të dyzuar. Është ajo vetë, realja, me qytetet katundare, mjerimin, fatalitetin, èndrrën ose më saktë makthin e saj, dhe janë dy librat e vegjël të tij, dy librat e tij të pabotuar ku janë përbledhur tërëjeta, tërë mendimet e përsiatjet e tij për këtë vend.

Do të ishte vallë djep e njëkohësisht varr i tyre? Apo do të kishte një zgjidhje tjetër, një zgjidhje shpërthyese, e stuhishme, tërmëtore, motive aq të shpeshta në veprën e tij?

Pyetja torturuese e ka munduar gjatë. Sëmundja ka ndërhyrë në jetën e tij me ngulm, duke u përpjekur të vëré në kontroll penën e tij, të diktojë klimën, ngjyrimin e përzishëm, deri ritmin e frazave. Pa dyshim që ka ndikuar në të gjitha këto kjo perde që mund të binte papritur, por asnjëherë ajo nuk shkakton tek ai panik, mos-përfillje, cinizëm, egërsim, ose të kundërtën e tyre përkëdhelje, filozofi të lirë, delir madhështie etj. Dhe gjithë kjo rezistencë e brendshme e tij realizohet falë vetëdijes së shkrimitarit të madh, që ai e ka si rrallë kush.

Në senatorumin San-Luigji të Torinos kur e ndien se ditët i ka të numëruara, gjithçka tek ai merr formë testamentiale. Në tre rreshtat e fundit që shkroi, përpara se t'i fillonin krizat e të

binte në koma, prej së cilës nuk do të përmendej më, pér herë të parë në veprën e tij përmend emrin e Skënderbeut.

C'ishte kjo përmendje e vonë, në kohën kur sytë po i erren dhe muzgu po bie?

Pa dyshim një përpjekje pér një bilanc të fundit e shtyrë pérherë nga vetëdija e krijuesit të madh.

Nuk dëshiron të vdesë pa shkruar dicka pér Heroin Kombëtar të popullit të vet. Nuk e ka përmendur emrin e tij gjer tani, me siguri, si reagim ndaj gjithë tradicionalistëve reaksionarë, që kishin bërë abuzime të mëdha me atë emër e ndaj vetë mbretit Zog, që pér ironi të fatit, e shpallte veten vazhdues të kurorës(!) e të veprës së Skënderbeut.

Por tanë, në mbarim të ditëve të tij, kur optika e gjërave i ndryshon me orë, e ndien se shkrimtarit të madh nuk i lejohet që pér shkaqe passioni e polemike të bjerë në provokacion, duke u bërë shurdh ose duke hequr dorë nga motivet e përdhosura prej të tjerëve. Shqipëria nuk është vetëm ajo që duket, por edhe ajo që s'duket, ashtu si shqiptarët nuk janë vetëm ajo popullsi që jeton aktualisht, por edhe breza të tërë që prej kohësh janë nën tokë (madje këta janë më të shumtët), dhe aq më tepër, ata që do të vijnë, që janë akoma më të shumtë. Dhe ai, si krijues i madh, u përket të gjithëve dhe dëshmon dhe kumton pér të gjithë. Kështu, pavarësisht se të tjerët kanë abuzuar me kujtimet historike, me legjendat, delirët

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

e fantazmat e mëdha të këtij populli, nuk është rruga më e mirë braktisja e tyre, por përkundrazi hetimi sa më i thellë e në mënyrë të re i gjithçkaje.

Por tani që s'i mbetet më kohë për të sqa-ruar mungesat, merr penën dhe, duke mbledhur energjitet e fundit, shton në veprën e tij emrin e njeriut që e mishëronte vërtet Shqipérinë e për-jetshme, njeriun me dy fe si ajo, me dy emra si një pjesë e shqiptarëve, së fundi njeriun që si një luan i deshpëruar që sjellur e turur midis dy kontinenteve për t'i gjetur Shqipërisë vendin që du-hej e për t'i dhënë historisë së saj kahjen që du-hej.

I shkroi, pra, ato tre rreshta në prozë (fjal-lët e fundit ishin «s'flitet ma»), dhe ndoshta me një lehtësim të fundit nisi të shuhej, gjersa vdiq, fare i qetë, siç dëshmojnë të gjithë më 28 gusht 1938.

Vargu i Poradecit:

«Fluturoi dhe shtergu i fundit madhështor me shpirt të gjorë», do t'i shkonte kësaj vdekje tragjike, aq më tepër që, sipas radhës së moshiës, Migjeni duhej të vdiste vërtet i fundit.

Por ai, në kundërshtim me radhën, ishte shtergu i parë që po i ikte.

I dyti, Noli, vdiq më 13 mars 1965 në SHBA dhe shtergu i fundit Poradeci vetë, gjysmë she-kulli pas Migjenit, në një ditë të ftohtë, më 12 nëntor 1987, në Tiranë.

Vdekja e Migjenit u prit në Shqipëri si një shenjë tjetër e keqe në një kohë fatkeqësish. Du-

kej se ora e ligë kishte rënë për kombin shqiptar. Vend i ndodhej në prag të katastrofës. Parandihej një robëri e një zi e re, e cila nuk vonoi të plakoste disa muaj pas vdekjes së tij, kur vendi u pushtua prej Musolinit.

Trupi i tij u varros në Tore Pelice të Italisë dhe për një kohë të gjatë qëndroi atje, gjersa Shqipëria e re, në shenjë nderimi për të, ia kërkoi eshtrat qeverisë italiane për t'i vendesur në qytetin e tij të lindjes, atij qyteti të Veriut, që ai i kushtoi disa nga perlat më të bukura të tij.

Një vapor e solli Migjenin nëpër po atë rrugë, që ai e kishte bërë kur kishte qenë gjallë.

Kishin ndodhur kaq ngjarje midis dy udhëtimeve. Po afronin vitet 60, kohë në të cilën Shqipëria do të shkëputej nga kampi socialist. Deti Adriatik, deti kryesor me të cilën Shqipëria kryente marrëdhëniet me jashtë, po shkretohej për shkak të një bllokade të papritur.

C'prej mijëra vjetësh nëpër atë det kishin vajtur e ardhur nga brigjet italiane te ato shqiptare e anasjelltas udhëtarë nga më të ndryshmit: tregtarë, misionarë, peshkopë, legionarë, piratë, konsuj, hierarkë fashistë, artistë kinemaje, prostituta, aventurierë, ushtarë. Tani në hapësirën e shkretuar po kalonin të vdekurit. Të dy vendet këmbenin eshtrat: Shqipëria po merrte një poet dhe pas tij disa intelektualë të shquar të saj, vdekur në atdheun e Dantes, Italia, ushtarët e vrarë gjatë luftës së fundit në Shqipëri.

Ishte një epilog i ngjashëm me ato të poemave antike.

10

Qysh në shkrimet e para, që u botuan për të fill pas vdekjes, ai u quajt një meteor në qiellin e letërsisë, krahasim i përdorur shpesh për shkrimtarët me jetë të shkurtër e rëndicim intensiv.

Pas heshtjes së viteve të para, u shkrua shumë për të, në radhë të parë në Shqipërinë e re, të cilën ai nuk arriti ta shihte, e pastaj në vende e gjuhë të tjera, ku u botua e vazhdon të bota het vepra e tij.

Duhet thënë se makina e kritikës letrare, siç ndodh shpesh në rastet e shkrimtarëve të mëdhenj, u gjet e papërgatitur dhe disi e vjetëruar për materien e tij të veçantë, të re e befasuese. Asaj iu desh kështu njëfarë kohe, sa të kryente brenda vetes riparimet e nevojshme, për të qenë në gjendje të merrej ashtu siç duhej me veprën e tij.

Studimi e zërthimit i saj, që duhet pranuar

se nuk është aq i lehtë, është bërë disa herë në mënyrë të pasaktë, të turbullt e kundërthënëse. Qëndrimet ndaj atij vetë kanë qenë disa herë të skajshme, duke nisur nga ajo kritikë skematike që është përpjekur ta paraqesë me çdo kusht si shkrimtar tipik revolucionar, pararendës të realizmit socialist, gjer te kritika moderniste e cila është përpjekur ta shpjegojë një pjesë të veprës së tij sipas klisheve të saj.

Nga leximi e pastaj hulumtimi i gjithçkaje që njohim pér të, ai shfaqet i plotë, i qartë e harmonik në tërësinë e vet. Në këtë rast duket me të vërtetë krejt i panevojshëm ai zell që kujton se mund ta pasurojë e ta bëjë më të përkryer një shkrimtar, duke i shtuar etiketa, qoftë të një drejtimi, qoftë të një tjetri. Këtu duhet thënë se nuk është vështirë të kuptohet se motivet e veprës së tij nuk e kanë burimin në ndonjë doktrinë apo sistem idesh, siç ka këmbëngulur kritika skematike, e aq më pak në zonat iracionale të ndërgjegjes, siç janë rrrekur të vërtetojnë modernistët.

Ai vetë ka lënë rrallë ndonjë shënim pér artin në fletoret, një pjesë e të cilave humbën gjatë luftës. Por në «Novelë mbi krizë» e shpall fare haptas veten armik të papajtueshëm të «artit me recetë».

Është quajtur disa herë Rembo shqiptar, por asnjëherë s'ka qenë e qartë se ç'pjesë ka në këtë krahasi vdekja e parakohshme, e ç'pjesë ka zyrtia e veprës së tij. Por në qoftë se nuk është

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

një Rembo, aq më pak është një Lermontov apo Klejst i maleve tonë. Ai është thjesht Migjeni, i vetëm jaftueshëm për të qenë shkrimtar i madh shqiptar, një ndër më të shqetësuarit shkrimtare evropianë të viteve 30, që jetoi dhe punoi në një vend e në një kohë të vështirë, tragjizmi i së cilës vulosi veprën e tij. Ajo është e paktë si vëllim, por me një tension të brendshëm të pazakonshëm. Në të, ashtu si në veprat e vërteta të artit, ndodh ajo dukuri e mrekullueshme kur biografia e shkrimtarit, përzihet, mpikset e shumohet nga mijëra e mijëra biografi të tjera njerëzish anonimë, dëshmia dhe drama e të cilëve nuk figuron në asnje kronikë, enciklopedi apo histori të shtetit. Ajo zgjerohet për t'i gjelltitur e mbështjellë të gjithë ata dhe për t'u tkurrur pas kësaj përsëri, në mënyrë që t'i afrohet shëmbëlltyrës e përmasës së një jete njerëzore. Kjo dukuri, një nga më mistériozet në art, mund të krahasohet ndoshta me bymimin e tkurrjen e universit, ashtu si e shpjetgojnë shkençtarët.

Ai u gjet kështu midis kohëve e brezave njerëzorë si një medium që duhej të dëshifronte e pastaj të kalonte mesazhe nëpër kahje që ngjanin të pakalueshme. Për ta bërë këtë, përveç që duhej të ishte në gjendje të përhershme transi, atij i duhej të provonte atë vuajtjen e vazhdueshme të gjithë krijuesve të mëdhenj kur dyshojnë për moskuptimin e kumtit ose për mosdëshifrimin e saktë të tij.

Për të dhënë gjithë rrëmetin e kohës, i cili

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

disa herë ishte në lëvizje të ethshme e disa herë në gjendje të ngrirë, Migjenit iu desh të krijojë një gjeografi të gjerë, që shtrihet nga fushat kontinentale ku enden popuj të tërë, gjer te kullat malësore ku jeta duket se është ngurtësuar përgjithmonë. Atij iu desh të përdorë forma e teknika të ndryshme të shkruari, të gërshtetojë lirizmin me epizmin, komiken me tragjiken, sarkazmën me groteskun. Atij iu desh t'u referohet miteve të vjetra e të reja të njerëzimit, nga kujtimet parablike gjer te personazhet e kohës, artistët e kinemasë, boksierët e politikanët. Gjithmonë për të realizuar një vizion global të botës, çka do t'i siguronte veprës kumbimin universal, ai herë do të përzihej plot pasion në ngjarjet që përshkruan, e herë do të hiqej mënjanë, për të dëshmuar nga larg, si një kronist epik. Shpesh në prozat e tij të shkurtra ndihet romani, që është kalcifikuar, në pritje për t'u zhvilluar më tej.

Kudo në veprën e tij ndihet ndalimi i parakohshëm, ndërprerja. Ai vetë mund të mendohet si i tillë: i ndërprerë. Por ndërprerja e tij nuk ngjan e zakonshme përderisa ajo është ndërprerja e një uragani.

Frymëmarrja, ritmi, pulsi i shkrimitarëve të tillë si Migjeni është i ~~pecantë~~. Dhe kjo është e kuptueshme. Ne njohim vetëm një lloj ritmi, atë të jetës njerëzore që vazhdon rrëth 70 vjet, por nuk jemi në gjendje të parashikojmë se si do të ishin shumë gjëra në botë, duke përfshirë këtu edhe artin, sikur jeta mesatare e njeriut, të ishte

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

më e madhe p.sh. rrëth 300 vjet, ose më e vogël, p.sh. rrëth 10 vjet.

Shkrimtarët që dinë ose, së paku, e ndiejnë se do të vdesin para kohe, kanë një ngutje të tyren. Megjithatë, duhet thënë se duke qenë nën trysninë e një ritmi të përgjithshëm, ata pengohen në ecjen e tyre, në po atë mënyrë që pengohet prej turmës njeriu që shpejton më shumë se ç'duhet në një stacion pasagjerësh. Kjo duhet të jetë edhe vuajtja më e madhe e këtyre të përkohshmeve.

C'do të shkruante më pas? C'la pa bërë? Në ç'lartësi do të ngjitej? Këto pyetje, ndonëse të mbeturë pa përgjigje, e në thelb të panevojshme, përsëriten, ashtu si shumë pyetje të tjera për njërezit e mëdhenj që brezat e rinj dëshirojnë t'i kenë midis tyre.

Por për shkrimtarin e vdekur para kohe, këto pyetje përsëriten sidomos gjatë asaj periudhe, brenda së cilës ai mund të ishte ende gjallë. Kjo është një periudhë e veçantë, kur ai që mungon, hijerëndë dhe sundues, siç janë shpesh munguesit (personazhe të para të epikës botërore), shkakton trazim, prishje drejtpeshimi, mëdyshje dhe madje ankth. Por përvjetorët kalojnë njëri pas tjetrit, kalon dyzetvjetori i lindjes, pesëdhjetëvjetori e kështu me radhë dhe trazimi nis të zbehet në po atë masë që mundësia e qenies ende gjallë të shkrimtarit nis e zvogëlohet. Së fundi vjen nëntëdhjetëvjetori e pastaj njëqindvjetori i tij dhe ideja se ai tani do të ishte me siguri nën tokë, sjell

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

te brezat njerëzorë po atë qetësi që shkakton te familjarët pas dy-tri ditësh cfilitëse ceremonie mortore, i vdekuri që më në fund kallet në dhe.

Kjo është edhe koha kur gjykimi për të, ndërsa humb pasionin e tepërt, fiton thellësinë.

Më 1950, kur letërsia e re shqiptare ndodhej nën bezdinë e skematizmit sovjetik, Migjeni do të ishte 39 vjeç. Më 1960, kur ajo me një kërcim tigri (apo ndoshta kaprolli), nisi të shkëputej nga ajo skemë, ai do të ishte 49 vjeç. Dhe më 1989, në kohën kur përfundoheshin këto shënimë, ai do të ishte në moshën 78 vjeç.

Sic shihet, koha e qetësisë ende nuk ka mbërritur për të, çka ndoshta ndihet në këto fletë.

«Mirë se erdhe, vëlla!». Me këto fjalë Dhimitër Pasko përshëndeti ne «Revistën letrare», në mars të vitit 1944, daljen e librit të parë të Migjenit «Vargjet e lira». Por Migjeni ndërkaq kishte gjashtë vjet që kishte vdekur. Kështu që formula e sakte e mirëseardhjes në këtë rast do të ishte «mirë se erdhe vëlla i vdekur!»

Por fjalët «vëlla i vdekur» për ballkanasit, e veçanërisht për shqiptarët, janë më shumë se kuptimi i tyre i drejtpërdrejtë. «Vëlla i vdekur» është personazhi kryesor i një prej baladave të tyre më të vjetra e më tronditëse, njeriu që u ngrit nga varri për të përbushur një premtim që s'kishë mundur ta kryente sa qe gjallë. Ndaj në poetikën ballkanase, e veçanërisht atë shqiptare, fja-

Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe

la e këtij personazhi të zbehtë e të pluhurosur nga balta, e këtij *transcendant* që ka bërë rrugën e praptë, të panatyrshme nga vdekja në jetë, ka një peshë e ogur të veçantë.

Unë djepi juej e ndoshta vorri juej, kishte shkruar vite më parë Migjeni për veprat e tij.

Ai e kishte shpërthyer më në fund varrin dhe po vinte t'i sillte letërsisë shqipe kumtin e tij të veçantë, me të gjitha vulat dhe peshën që i jepte rikthimi nga terri.

Tiranë, 1988-1989

II Poëzë e Migjenit

Këndui Poëzopoj →

"Dritë", 13 tetor 1991

Monografie e Migjenit, ~~Ylli~~

Rudol Merku
Alfred Urd
3 shtator

Teodor Bela,

II